

UNIVERSITETI I EJL  
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK  
ПРАВНИ ФАКУЛТЕТ  
LAËFACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEMA:

POZITA JURIDIKO-TRASHËGIMORE E BASHKËSHORTËVE  
MARTESORË DHE JASHTËMARTESORË

Mentori: Doc. Prof. Dr. Emine Zendeli

Kandidati: Sibel Rashit ID:120840

Tetovë, 2018

## Përmbajtja

Hyrje.....	5
Kapitulli I.....	8
1.Zhvillimi historik i pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë në periudha të ndryshme historike .....	8
1.1.Periudha e lashtë.....	9
1.1.1. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve në periudhën antike-greke.....	9
1.1.2. Roma lashtë.....	11
1.1.2.1. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë në Romën e lashtë.....	11
1.1.2.2. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve jashtëmartesorë në Romën e lashtë.....	14
1.2. Periudha e mesme.....	15
1.2.1. Pozita e bashkëshortëve martesorë në periudhën e mesme.....	15
1.2.2. Pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë në periudhën e mesme.....	17
1.3. Periudha e re.....	18
1.3.1. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Francez.....	18
1.3.2. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodi i përgjithshëm pasuror Austriak(ABGB) .....	19
1.3.3. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Gjerman (BGB).....	19
1.3.4. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Zvicëran.....	20
1.3.5. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Italian.....	21
1.4. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve në të drejtën Islame.....	22
Kapitulli II .....	25

2. Zhvillimi historik të pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë në Republikën e Maqedonisë .....	25
2.1. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1955.....	25
2.2. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1973 .....	27
2.3. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1996.....	28
Kapitulli III.....	29
3. Baza juridike e thirjes në trashëgimi.....	29
3.1. Gjinia si fakt për caktimin e radhëve të trashëgimisë.....	30
3.2. Lidhja martesore si fakt për caktimin e trashëgimisë.....	32
3.3. Jetesa e përbashkët.....	32
4. Radhët e trashëgimisë sipas ligjit për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë.....	33
4.1. Bashkëshorti/ja në radin e parë të trashëgimisë.....	33
4.1.1. Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radhën e parë të trashëgimisë.....	35
4.1.2. Zvogëlimi i pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radhën e parë të trashëgimisë.....	37
4.2. Bashkëshorti/ja në radin e dytë të trashëgimisë.....	39
4.2.1. Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radin e dytë të trashëgimisë.....	42
4.2.2. Rritja e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radin e dytë të trashëgimisë.....	44
4.3. Humbja e së drejtës trashëgimore të bashkëshortit.....	48
5. Të drejtat e tjera që i përkasin bashkëshortit.....	51
5.1. Pasuria e përbashkët e bashkëshortit.....	51
5.2. Sendet e amvisërisë.....	53
5.3. Sendet për përdorim personal.....	54

Kapitulli IV.....	55
6.Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve jashtëmartesorë.....	55
6.1. Nocioni i bashkësisë jashtëmartesor.....	57
6.2.Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve jashtëmartesorë në Republikën e Maqedonisë.....	59
6.3.Të dhëna statistikore për bashkëshortët jashtëmartesorë.....	66
6.4.Rregullimi juridiko-trashëgimor i bashkësisë jashtëmartesore në të drejtën krahasuese.....	69
Kapitulli V.....	73
7.Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë në të drejtën krahasuese.....	73
7.1. Pozita juridiko trashëgimore e bashkëshortëve martesorë në vendet Europiane..	73
7.1.1. Gjermani.....	73
7.1.2. Fransa.....	76
7.1.3.Italia.....	79
7.2 Pozita juridiko trashëgimore e bashkëshortëve martesorë në vendet Anglo–Saksone.....	81
7.2.1. Britania e Madhe.....	81
7.2.1.1. Skocia.....	81
7.2.1.2. Anglia dhe Uelsi.....	84
7.2.1.3. Irlanda e Veriut.....	86
7.2.2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	87
8.Përfundimi dhe konkluzioni.....	89
9.Biblografia.....	92

## HYRJE

Martesa është bashkëjetesë ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza të unitetit në familje.<sup>1</sup>

Neni 2 i Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë familjen e përkufizon si bashkësi jetësore të prindërve, fëmijëve dhe të personave të tjerë në gjini, nëse jetojnë në një familje të përbashkët.<sup>2</sup> Pra, me këtë mund të kuptojmë se familja është në qendër të jetës së njeriut, jo vetëm sa i përket aspektit emocional por edhe aspektit legjislativ prandaj edhe ligji me normat e veta mundohet në një farë mënyre të bëj balansimin, stabilizimin e jetesës së njerëzve apo anëtarëve familjar.

Në këtë studim do të vendosen në pah dy çështje kryesore që në njërin anë janë të ndarë nga njëri-tjetri kurse në anën tjetër kemi ndërlidhjen e këtyre dy lëndëve të cilët janë familja dhe trashëgimia. Martesa, përbën bazën e ligjshme të familjes, prandaj një nga detyrat më të rëndësishme të shtetit dhe shoqërisë është kujdesi për forcimin e martesës.<sup>3</sup> Bashkësia martesore është bashkësi e lirë, solemn i jetesës së një burri dhe një gruaje, me të cilën vendosin për jetë të përbashkët dhe krijimin e familjes, sipas kushteve për lidhjen, pasojat dhe zgjidhjen e saj të paraparë me dispozita ligjore.<sup>4</sup>

Bashkësia jashtmartesore është bashkësi faktike midis burrit dhe gruas. Qëllimi themelor i formimit të saj është jetesa e përbashkët, e cila duhet të ketë zgjatur një periudhë të konsiderueshme kohore dhe të jetë e vazhdueshme.<sup>5</sup> Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë me bashkësinë jashtmartesore kuptojmë bashkësinë e një burri dhe një gruaje e cila nuk është themeluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe e cila ka zgjatur së paku një vjet, është e barabartë me bashkësinë martesore sa i përket të drejtës së mbajtjes reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> <http://njohligjin.al/familja/martesa/>, (05.06.2018).

<sup>2</sup> Neni 2, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.80/92.

<sup>3</sup> Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2006, fq.9.

<sup>4</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, "E drejta familjare", Prishtinë, 2007, fq.86.

<sup>5</sup> Po aty, fq 141.

<sup>6</sup> Neni 13, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.80/92.

Marrëdhëniet pasurore përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe integrale të marrëdhënieve familjare dhe të drejtës familjare. Ato janë të lidhura ngushtë dhe të gërshetuara me marrëdhëniet personale të cilat ndodhin në mes të anëtarëve të familjes. Lidhja që egziston mes dy bashkëshortëve në krijimin e pasurisë, marrëdhënieve pasurore u jep specifika të veçanta të cilat, sa i përket krijimit të pronësisë, nuk mund të hasen mes personave të tretë. Në këtë kontekst marrëdhëniet pasurore të natyrës familjare për dallim nga marrëdhëniet pasurore tjera lindin vetëm mes antarëve të familjes: bashkëshortët martesorë, bashkëshortët jashtëmartesorë dhe mes prindërve dhe fëmijëve.<sup>7</sup> Bashkëshortët përveç pasurisë që krijojnë në martesë ato kanë edhe pasurinë e tyre të veçantë që kanë sjellë me trashëgimi. Thelbi i punimit qëndron në rastet kur bashkeshorti martesorë dhe jashtëmartesorë mund të paraqitet si trashëgimtar i bashkeshortit (trashëgimlënësit).

Trashëgimia përbën një ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës dhe kjo për faktin jo vetëm se është një marrëdhënie juridike e cila has zbatimin më të shpeshtë dhe të vazhdueshëm në praktikë, por ajo çka është më e rëndësishme për këtë institut vjen si pasojë e objektit të këtij instituti, i cili ka të bëjë me kalimin apo transferimin e të drejtave dhe detyrimeve pasurore vetëm si pasojë e vdekjes së titullarit i cili ishte bartës i këtyre të drejtave dhe detyrimeve. Pra, e gjithë tërësia e marrëdhënieve juridike si pronësia e të mirave materiale, të drejtat sendore mbi sendet e të tjerëve, garancitë reale, kreditë dhe detyrimet që iu transferohen trashëgimtarëve si pasojë e vdekjes së titullarit që i mbarte këto të drejta do të quhet pasuri trashëgimore dhe personi që i transferon këto të drejta do të quhet trashëgimlënësi. Nga përkufizimi i mësipërm, pra kalimi i disa të drejtave dhe detyrimeve nga një person tek një person tjetër rezulton se ka në thelb të tij dy karakteristika kryesore. Mund të thuhet se kemi njëkohësisht shuarjen dhe lindjen e të drejtave dhe detyrimeve. Si mund të kuptohet kjo? Është e qartë që me vdekjen e personit që gëzon të drejta dhe detyrime, kemi edhe shuarjen e këtyre të drejtave pasi personi nuk është më i aftë t'i gëzojë ato. Është pikërisht ky momenti në të cilin pasuria humb titullin e saj. Menjëherë pas vdekjes së personit, vjen në jetë instituti i trashëgimisë, në mënyrë që jo vetëm të mundësojë transferimin e këtyre të drejtave por edhe të rregullojë të gjithë këtë transferim duke u bazuar në parashikimet ligjore që lidhen me ndarjen, kalimin dhe

---

<sup>7</sup>Трпеновска- Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Семејно право", Скопје, 2013, ст.307.

përcaktimin e personave që trashëgojnë.<sup>8</sup> Që në të drejtën e vjetër ka egzistuar rregulla “*viventis non datur hereditas*” që do me thënë se i gjalli nuk mund të trashëgohet, pra vdekja është ajo që hap rrugët për të trashëguar.<sup>9</sup> Vdekja është fakt juridik, me vdekjen e një personi marrëdhënjet e tij juridike nuk pushojnë por pasuria a tij kalon tek personat e tjerë, subjektët e tjerë juridik. Egzistimi i pasurisë trashëgimore paraqet kusht themelor për krijimin e marrëdhëneve juridike të trashëgimisë.<sup>10</sup>

Pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, në shekuj, brez pas brezi ka kaluar tek trashëgimtarët sipas bazave juridikisht valid për thirje në trashëgimi. Sipas të drejtës pozitive dy janë bazat e thirjes në trashëgimi: me ligj dhe me testament. Në bazë të kësaj vjen në shprehje ajo se në çfarë pozite vendosen bashkëshortët në trashëgimi, se si ligdhënësi në Republikën e Maqedonisë e rregullon pozitën e bashkëshortëve në radhët e trashëgimisë dhe ndryshimet apo krahasimet me vendet e tjera.

Në këtë studim do të shpjegojmë edhe pozitën e bashkëshortëve jashtmartesorë në Republikën e Maqedonisë dhe në të drejtën krahasuese. Rritja e numrit të personave që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore shtron çështjen e analizimit të kësaj problematike, se si ligdhënësi rregullon këtë çështje por edhe se si rregullohet në praktikën gjyqësore. Pas miratimit të ndryshimeve të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë në vitin 2014, vërejmë tendenca për ndryshimet përkatëse të Ligjit për familje në drejtim të definimit të bashkësisë jashtëmartesorë si bashkësi e regjistruar jashtmartesore mes një burri dhe gruaje.

Kam zgjedhur këtë punim për shkak se është e nevojshme që të qartësohen disa nene, në ligjin tonë për trashëgimi dhe mendoj se është e nevojshme për një interpretim që bashkëshortët të jenë në dijeni me të drejtat e tyre, prandaj ky punim do të jetë një hulumtimi i gjerë dhe i nevojshëm për çdonjë.

---

<sup>8</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtise-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>, (08.04.2018).

<sup>9</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, “*E drejta trashëgimore*”, Prishtinë, 2007, fq.37.

<sup>10</sup> Podvorica Hamdi, “*E drejta trashëgimore*”, Prishtinë, 2006, fq.10.

## KAPITULLI I

### 1. Zhvillimi historik i pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë në periudha të ndryshme historike

Familja është njëra nga institucionet më të rëndësishme juridike dhe shoqërore. Familja nuk është institucion statik. Ajo është në zhvillim të vazhdueshëm dhe gjatë transformimit historik mori trajta të ndryshme.

Familja është një institucion që çdoherë has ndryshime, ajo nuk qëndron kurrë në një vend, por shkon nga një formë më e ulët në një formë më të lartë, krahas zhvillimit të shoqërisë nga një shkallë më e ulët në një shkallë më të lartë. Pra familja në shekuj vazhdimisht është zhvilluar, në përshtatje me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, duke marrë trajta dhe karakteristika specifike.<sup>11</sup>

Për një kohë shumë të gjatë, bashkëshorti është konsideruar si i huaj në familje. Kjo e fundit ndërtohej vetëm me lidhje gjaku. Si rrjedhojë e këtij parimi, bashkëshorti thirrej për të marrë pjesë në trashëgimi vetëm në rast se trashëgimlënësi s'kishte asnjë të afërm. Me kalimin e kohës konceptime të tilla filluan të ndryshonin. Sot bashkëshorti është pjesëtar i vërtetë i familjes. Bashkëshorti është madje pjesëtar më i afërt i familjes, pavarësisht mungesës së lidhjes së gjakut. Këto të dhëna sociologjike kanë bërë që të ndryshojë pra hierarkia e trashëgimtarëve. Qëllimi për këtë të fundit ka qenë që të përmirësojë gjithnjë e më shumë situatën e bashkëshortit pasjetues, duke ruajtur në një lloj mënyre strukturën origjinale të sistemit.<sup>12</sup>

Problemi legjislativ i të drejtave trashëgimore të bashkëshortit pasjetues është shumë delikat, sepse situata e tij nuk mund të krahasohet me atë të trashëgimtarëve të tjerë, prandaj fillimisht do të analizojmë zhvillimin historik të pozitës juridiko trashëgimore të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë për të kuptuar rolin dhe rëndësinë gjatë gjithë periudhave historike e deri në ditët e sotme.

---

<sup>11</sup> Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2006, fq.31.

<sup>12</sup> <http://alblexus.blogspot.mk/2011/09/bashkeshorti-pasjetues-dhe-trashegimia.html>, (09.04.2018).



## 1.1. Periudha e lashtë

### 1.1.1. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve në periudhën antike-greke

Pavarësisht studimeve bashkëkohore, njohuritë tona rreth së drejtës së trashëgimisë dhe rregullimit të saj në antikitetin grek, nuk janë akoma të tilla që të lejojnë një paraqitje të plotë dhe organike e cila mund të përbëjë një doktrinë dominuese. Pjesën më të madhe të informacionit mbi të drejtën e trashëgimisë e kemi për shekujt V dhe VI dhe përsa i përket së drejtës trashëgimore mund të thuhet se ajo na ofron modelin e rregullimit të trashëgimisë të një qytet-shteti të Greqisë (Polis). Në të drejtën e antikitetit grek familja kishte një regjim të veçantë familjar. Sipas këtij regjimi familja përbënte një *“oikos”*, koncept ky që nënkuptonte termin *“familje”* por që kjo familje kishte një kryetar të sajën i cili quhej *“kyrious”* që nuk do të thotë gjë tjetër veçse *“zotëria”* që drejton këtë familje.<sup>13</sup>

Duke analizuar të drejtën trashëgimore në periudhën antike-greke, duhet të merren parasysh ndikimi i madh i religjionit dhe mundësia që të rruhet kultura, afërsia familjare, të cilët sollën deri në rregulla të reja të veçanta për rregullimin e trashëgimisë në periudhën antike-greke.

Në periudhën e lashtë, pasurinë trashëgimore e ka trashëguar djali më i madh i familjes, por ai nuk ka pasur të drejtë ta tjetërsojë pasurinë, por ka qenë vetëm posedues i pasurisë që e ka trashëguar dhe ka pasur si detyrë që pasurinë ta trashëgojë gjeneratave të ardhshme.<sup>14</sup>

Trashëgimia në periudhën e lashtë antike-greke në masë të madhe varret nga marrëdhënjet mes burrit dhe gruas. Gratë në Greqi kanë qenë nën kujdestarinë e babait të tyre derisa të lidhin martesë, pas lidhjes së martesës kanë kaluar nën kujdestarinë e burrit. Gratë nuk kanë pasur të drejta ligjore në trashëgimi, për shkak se në të gjithë të drejtat që kanë hyrë patjetër duhej të lidhej nën pajtimin e kujdestarit.

Një rast tjetër i rregullimit të trashëgimisë ishte dhe rasti kur trashëgimlënësi nuk kishte asnjë pasardhës të tij të gjinisë mashkull, por vetëm bija. Në këto raste pretendohet

---

<sup>13</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf> (10.04.2018).

<sup>14</sup> House Hold Faxhall Lin, Gebder and Property in Classical Athens, *The classical Quarterly*, new series, vol.39, no.1, 1989, fq.26.

se bija do të martohej dhe do të kishte pasardhës një fëmijë të seksit mashkull, i cili jo vetëm do të trashëgonte pasurinë por edhe do të vazhdonte kështu traditën e “*oikos*”. Në antikitetin grek, trashëgimtarja bijë quhej “*epikleros*” dhe nuk do të mund të dispononte trashëgiminë e babait të saj, derisa fëmija i saj i seksit mashkull do të arrinte moshën madhore. Duke qenë se “*epikleros*” do të mbante në përdorim të gjithë pasurinë e trashëguar, dhe po kështu edhe bashkëshorti i saj, e drejta e antikitetit grek kishte vendosur edhe rregullin e përgjithshëm sipas së cilit, e bija detyrohej të martohej më njërin nga meshkujt më të afërt, kushërinj të babit të saj. Nëse njëkohësisht ekzistonte disa meshkujt, atëherë më i madhi prej tyre kishte të drejtën për të zgjedhur për lidhjen e kësaj martesë. E njëjta gjë ndodhte edhe në rastet nëse bija trashëgimtare ishte e martuar. Nëse ajo kishte një pasardhës të seksit mashkull, çdo gjë ishte në rregull, ky do të ishte trashëgimtari i pasurisë. Por, në rast se bija nuk kishte asnjë fëmijë nga martesja, atëherë ajo ishte e detyruar të divorcohej nga bashkëshorti i saj, dhe kështu të martohej me kushëririn e saj më të afërt në mënyrë që ai të kishte të drejtën e kontrollit të pasurisë së trashëguar.<sup>15</sup>

Aristoteli thotë se nënshtrimi apo varësija e grave del nga natyra e tyre pasi që “*gjinia mashkullore për nga vet natyra e tyre janë më të gjindshëm, më të aftë për të qeverisur në krahasim me gratë*”.<sup>16</sup>

Detyra kryesore e grave ka qenë që ti kryejnë punët e shtëpisë dhe të kujdesen për fëmijët e tyre, burrat kanë pasur fuqi të plotë ndaj grave, fëmijëve dhe robve në familje, kurse marrëdhëniet familjare kanë qenë të rregulluara me norma morale.<sup>17</sup> Në rastet kur trashëgimlënësi nuk kishte asnjë pasardhës, pasuria e tij kalonte të afërmeve në një rend të caktuar (vëllezërve, motrave, vëllezërve dhe motrave me të njëjtën nënë etj.) por gjithmonë duke pasur përparësi të afërmit e seksit mashkull.<sup>18</sup>

---

<sup>15</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>, (10.04.2018).

<sup>16</sup> Zrinka Erent-Sunko, *Obitelj u demokratskoj Ateni-institucija i polis u malom, Zbornik Pravnog Fakultet u Zagrebu*, godina 57, broj 3, Zagreb 2007, fq.608.

<sup>17</sup> Трпеновска- Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.19.

<sup>18</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>, (10.04.2018).

## 1.1.2. Roma e lashtë

### 1.1.2.1. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë në Romën e lashtë

E drejta Romake ka qenë një pikë referimi shumë e rëndësishme për të gjitha sistemet ligjore, veçanërisht ato që i përkasin familjes ligjore të civil law edhe sot e kësaj dite, edhe pse çdo shtet ka ligjet e tij përkatës për rregullimin e një marrëdhënie të caktuar, e drejta romake vazhdon të mbetet baza kryesore.

Një rregullim tepër të veçantë dhe të rëndësishëm në të drejtën romake ka pasur instituti i trashëgimisë, i cili bënte pjesë në të drejtën private dhe përfshihej në rregullat e marrëdhënieve pronësore të atyre personave që gëzonin të drejta pronësore të ashtuquajtura "*ius quod ad res pertinet*". Në "*ius quod ad res pertinet*" përfshihen rregullat e pronësisë, të drejtave sendore mbi sendet e huaja, rregullimi i posedimit, të detyrimeve dhe trashëgimisë. Një aspekt i veçantë i marrëdhënies trashëgimore në të drejtën romake, ishte nocioni i trashëgimisë universale (universitas) sipas së cilës parashikohej kalimi i pasurisë pas vdekjes së një personi tek një subjekt tjetër. Trashëgimia që lindte si pasojë e vdekjes së një personi titullohej si trashëgimia mortis causa, pasi shkak kryesor i çeljes së trashëgimisë ishte pikërisht vdekja e personit (heres) dhe vetëm nga ky çast do të mund të lindte e drejta për të kaluar apo transferuar pasurinë e tij tek trashëgimtarët (heredes).<sup>19</sup> Në të drejtën romake egzistonte trashëgimi ligjore dhe testamentare. Rrethi i personave që kanë trashëguar në bazë të ligjit ka ndryshuar varësisht nga rrethanat ekonomike dhe politike.

**Në të drejtën e vjetër** trashëgimia ligjore është bazar në familjet agnate<sup>20</sup>, sipas së cilës lidhjet familjare janë bazar në jetesën e përbashkët. Në të drejtën e vjetër kanë egzistuar 3 radhë të trashëgimisë: në radhën e parë ka hyrë *heredes sui*, respektivisht personat që kanë jetuar me trashëgimlënësin dhe me vdekjen e tij janë kthyer në persona *sui iuris* (trashëgimtar), në radhën e dytë të trashëgimisë kanë hyrë ato *agnatë* që

---

<sup>19</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>, (11.04.2018).

<sup>20</sup> Në të drejtën e lashtë romake gjinia nuk merrej sipas gjakut dhe prejardhjes, por sipas faktit të jetës së përbashkët. Kjo ishte gjini e ashtuquajtur agnate. Kur zhvillimi i fuqisë prodhuese bëri të mundshëm jetën e grupeve më të vogla prodhuesish se konzorciumi, në Romë u organizuan familje patriakale të agnatëve. Qëllimi i këtyre bashkësive ishte që me jetë dhe punë të përbashkët të siguronin mjete të domosdoshme për egzistencën e anëtarëve dhe vazhdimin e familjes.

ndonjëherë kanë jetuar në patria potestasin e njejtë si edhe trashëgimlënësi, kurse në radhën e tretë të trashëgimisë kanë hyrë *gentilët*.

**Në të drejtën klasike** vjen deri në ndryshimin e trashëgimisë ligjore, në të cilën familjet romake më nuk përbëjnë bashkësi që themelohej nga familjet agnate, por nga *familjet kognate*<sup>21</sup>.

**Në të dejtën postklasike** trashëgimi është rregulluar me Novelën e 118 dhe 127 të Justinianit. Në radhën e parë kanë hyrë pasardhësit e tij, në radhën e dytë kanë hyrë paraardhësit, vëllezërit, motrat e plotë, në radhën e tretë të trashëgimisë kanë hyrë vëllezërit dhe motrat jo të plotë, në radhën e katërt kanë hyrë prindërit nga vija e tërthortë kurse në radhën e pestë bashkëshorti.<sup>22</sup>

Pozita juridiko trashëgimore e gruas në të drejtë romake varej nga forma e lidhjes së martesës. **Martesa me manus** ishte martesë tipike e të drejtës së lashtë. Në këtë martesë gruaja bëhej anëtare e familjes së burrit dhe varrej drejtëpërdrejtë nga kryetari i familjes. Ajo bëhej agnat me agnatët e burrit, ndërsa nuk ishte më agnat me familjen e atit. E tërë pasuria e gruas kalonte mbi kryetarin e familjes së re. E drejta themelore dhe e vetme që e fitonte gruaja në martesë me manus ishte e drejta e trashëgimit.<sup>23</sup> Gruaja nga martesë manuale ka pas statusin e filiae, respektivisht ka pas pozitë të njëjtë trashëgimore si edhe fëmitë.

Forma e dytë e martesës, **martesa pa manus** karakterizohet nga ajo që gruaja edhe pas lidhjes së martesës mbetet nën ndikimin e pater familjasit dhe në bazë të saj ka mbajtur të drejtën e trashëgimisë por nuk ka pasur të drejtën të jetë trashëgimtare e bashkëshortit të saj. Në martesat pa manus, gruaja nuk bëhej agnat me agnatët e burrit, por ngelte agnat në familjen e saj të mëparshme. Gruaja nga martesë jomanuale nuk ka pasur asnjë të drejtë të trashëgimisë nga bashkëshorti pasi që është konsideruar sikurse nuk hyn apo nuk i takon familjes së tij. Kurse burri asnjëherë nuk ka pasur asnjë të drejtë të trashëgimisë së gruas,

---

<sup>21</sup> Në të drejtën e lashtë romake si të afërm pavarësisht nga çështja e bashkësisë së jetesës, merren të gjithë personat që midis tyre kishin lidhje gjaku. Kjo ishte gjini e ashtuquajtur gjini kognate. Të afërm kognatë ishin të gjithë personat që direkt apo indirekt rrjedhin të paktën nga një paraardhës i përbashkët. Familjet kognate lindën gradualisht dhe u zhvilluan me përmirësimin ekonomik dhe personal të pozitës së personave alieni juris me mbizotërimin e martesës pa manus, si dhe me rendin e ri ligjor të trashëgimit.

<sup>22</sup> Puhan Ivo, "Rimsko Pravo", Naucna Knjiga, Beograd, 1969, fq.372-377.

<sup>23</sup> [https://www.slideshare.net/ervinakrasniqi71/e-drejtromake\(08.06.2018\)](https://www.slideshare.net/ervinakrasniqi71/e-drejtromake(08.06.2018)).

përderisa gruaja ka pasur pasuri.<sup>24</sup> Martesa pa manus kishte pasoja të caktuara juridike që rezulton nga fakti i egzistimit të lidhjes martesore: burri dhe gruaja ishin të detyruar ta respektonin dhe të ndihmonin njërin-tjetrin dhe të abstenonin çdo veprim që do të rezikonte egzistimin e bashkësisë martesore. Pozita e pavarur e gruas në martesën pa manus shkaktoi mohimin e të drejtave trashëgimore të gruas në familjen e burrit, bile iu mohua e drejta reciproke trashëgimore midis nënës dhe fëmijëve. Nëna dhe fëmijët nuk ndodheshin në gjini agnate, por vetëm në atë kognate.<sup>25</sup>

Në periudhën postklasike, Justiniani në Novelën e tij 53 dhe 117 e përmirëson pozitën juridiko-trashëgimore të gruas. Principi Pretorian vazhdon të egzistojë edhe më vonë, bashkëshortes i takon pasuria e tërë nëse nuk ka trashëgimtar tjetër që të trashëgojë.

E veja që ka qenë në martesë valide me trashëgimlënësin dhe e cila nuk ka qenë materialisht e siguruar ka pasur të drejtë të kërkojë trashëgimi, sipas së cilës i ka takuar ¼ nga trashëgimia. Në këtë rast mund të vërehen dy situata: sipas së parës gruaja të konkurojë me fëmitë e trashëgimlënësit (pa marrë parasysh nga cila martesë), nëse ato janë më shumë se tre, ajo do të fitojë pjesë të barabarta me to; kurse në rastin e dytë gruaja konkuron me fëmitë nga martesë e vet sipas së cilës asaj nuk i takon pjesë trashëgimore por vetëm posedimin e pasurisë kurse pasuria trashëgimore i takon vetëm fëmijëve.<sup>26</sup>

E drejta romake ka pasur ndikim të madh në formimin e të drejtës trashëgimore, posaçërisht në përmirsimin e pozitës juridiko-trashëgimore të gruas në periudha të ndryshme historike. Shumë vende Evropiane disa më shumë e disa më pak kanë pas ndikim nga e drejta romake veqanërisht nga rregullat e Justinianit.

---

<sup>24</sup>Борислав Т. Благоја, *“Правна Енциклопедија”*, Београд, 1989, fq.132. dhe Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследувањето во Европа”*, Скопје, 2011, fq.24.

<sup>25</sup> <https://www.slideshare.net/ervinakrasniqi71/e-drejtromake>, (08.06.2018).

<sup>26</sup>Борислав Т. Благоја, *“Правна Енциклопедија”*, Београд, 1989, Fq.132

### 1.1.2.2. Pozita juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve jashtmartesorë në Romën e lashtë

Bashësia jashtmartesore ka egzistuar pothuajse në të gjithë periudhat historike. Marëdhënjet mes burrit dhe gruas të cilat kanë qenë të ngjajshme me martesën kanë egzistuar edhe në kohën e së drejtës romake. Martesa ka qenë e vetmja bashkësi ligjore mes burrit dhe gruas në romën e lashtë. Kanë egzistuar ndalesa apo **Lex Iulia de adulteries** ka ndaluar:

- ❖ **Sturprum** – marëdhënjet seksuale mes burrit të lirë dhe gruas së pamartuar
- ❖ **Adulterium** - marëdhënjet seksuale mes të cilëve së paku njëri prej tyre gjendet në martesë
- ❖ **Incestum** - marëdhënjet seksuale mes të afërmeve familjarë (farefis) për të cilët ka qenë e ndaluar të lidhin martesë.

Megjithatë e drejta romake ka njohur konkubinatin e cila paraqet bashkësi jetese mes një burri dhe gruaje që nuk kanë dëshiruar të lidhin martesë ose nuk kanë mundur të lidhin martesë. Fëmijtë e lindur në konkubinatin nuk kanë hyrë në familjen e burrit.

Kanë egzistuar ndryshime sa i përket kësaj sfere në periudhën postklasike, sipas së cilës i mundësohet fëmijëve të lindur në konkubinatin të ligjësohen- u njihet e drejta e mbajtjes dhe trashëgimisë së kufizuar.<sup>27</sup>

---

<sup>27</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2010, fq.68-69.

## 1.2. Periudha e mesme

### 1.2.1. Pozita e bashkëshortëve martesorë në periudhën e mesme

Në fillimin e periudhës së mesme, në fiset gjermane nuk mund të flitet për trashëgiminë në kuptimin e plotë të fjalës. Fillimisht në rast të vdekjes sendet kanë mbetur në shfryrëzim të përbashkët, e deri më vonë janë paraqitur rende sipas së cilëve të afërmit mund të paraqiteshin si trashëgimtarë.<sup>28</sup> Pra, e drejta e popujve gjermanikë i jepnin përparësi shumë të madhe institutit të trashëgimisë ligjore sesa trashëgimisë testamentare. Në periudhën mesjetare e drejta e trashëgimisë shihej e lidhur ngushtësisht me familjen, pasurinë familjare dhe fuqinë që i njihej atit të familjes për të zgjedhur trashëgimtarët e tij dhe më pas ndarjen e saj. Pas vdekjes së atit, bijtë trashëgonin pasurinë e tij dhe nuk mund të hiqnin dorë prej saj nëse nuk ishin përjashtuar më parë në vullnetin e shfaqur të trashëgimlënësit. Pas vdekjes së trashëgimlënësit, ishin pikërisht meshkujt e familjes ata të cilët merrnin titullin e trashëgimtarit dhe dispononin lirisht pasurinë e trashëguar.

Tacioti shkruan për trashëgiminë tek gjermanët se egzistojnë tre parantela:

- ❖ **Në parantelën e parë** janë pasardhësit e trashëgimlënësit,
- ❖ **Në parentelën e dytë** janë pasardhësit e prindërve të trashëgimlënësit - vëllezërit dhe motrat e tij,
- ❖ **Në parentelën e tretë** janë pasardhësit e gjyshërve dhe gjysheve të trashëgimlënësit- axhallarët, dajallarët, tezet e tij.

**Ligjet Turungiake** kanë qenë ligje shumë të repta për pozitën e gruas në trashëgimi, kështu që gratë nuk mund të paraqiten si trashëgimtare përderisa egzistojnë meshkuj pa marrë parasysh nga cila rradhë trashëgimore gjenden. Gruaja nuk ka pas të drejtë në trashëgimi dhe me lidhjen e martesës ajo kalon në familjen e bashkëshortit te saj si rezultat i shitjes sipas së cilës nuk ka fituar asnjë send por vetëm ka kaluar në familjen e bashkëshortit.<sup>29</sup>

---

<sup>28</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.29.

<sup>29</sup> По аty, fq.29.

Më vonë **ligjet Vizigote, Bavare dhe Alemane** lejojnë që gruaja të trashëgojë, këtu vërejmë përmirësimin e pozitës së gruas. Kështu që në periudha të ndryshme historike vërehen edhe ndryshime sa i përket pozitës së gruas.

Në periudhën e mesme kanë egzistuar dallime në të drejtë trashëgimore mes shteteve që e kanë pranuar të drejtën romake dhe shteteve që zbatojnë të drejtën zakonore. Në zonat që kanë qenë nën ndikimin e së drejtës romake, ndikim të madh kanë pasur rregullat e Justinianit (Novela 118 dhe 127) ku përparësi jepej trashëgimisë testamentale. Nëse nuk ka egzistuar testament atëherë si trashëgimtarë janë thirrur pasardhësit, paraardhësit dhe kushërinjtë anësorë kurse në fund bashkëshorti. Në zonat ku kanë zbatuar të drejtën zakonore principi kryesorë ka qenë që trashëgimia të mbetet në familje. Për këtë shkak, bashkëshortët nuk kanë pasur të drejtën për trashëgimi, përderisa kanë egzistuar trashëgimtarë ligjorë.<sup>30</sup>

Në këtë periudhë egzistojnë rregulla sipas së cilës vendi i gruas në ndarjen e pasurisë është plotësisht e caktuar- ajo është trashëgimtare vetëm nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë. Pasuria e prejardhur si dhe pasuria e fituar në martesë paraqet pasuri e veçantë e secilit bashkëshort.<sup>31</sup>

Për pozitën juridiko-trashëgimore të gras, dhe vendin e saj në trashëgimi mund të kuptojmë nga fragmentet dhe librat e shek.XIV deri në fillim të shek.XVI. Për dallim nga e drejta zakonore e shek XIII, nga shënimet e mbetura nga fundi i shekullit XIV dhe fillim i shekullit XVI – gruaja është prima dhe vera heres të babait dhe bashkëshortit të saj.<sup>32</sup> Sipas burimeve të shekullit XIV dhe shekullit XVI, vajzat e trashëgimlënësit në aspektin e trashëgimisë janë të barabartë me vëllezërit dhe janë trashëgimtar në rendin e parë të trashëgimisë.

E drejta e gruas që të jetë trashëgimtare nuk ka qenë njëlloj e rregulluar në të gjithë vendet Evropiane. Të drejtat e grave kanë qenë të kufizuar, kjo vërehet nga ajo se statusin gruaja e ka fituar nga babai ose burri.

---

<sup>30</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследувањето во Европа”*, Скопје, 2011, fq.32.

<sup>31</sup> По аty, fq.32.

<sup>32</sup> Apostolova Marsavelska Magdalena, *ZAGREBAKI GRADEC POLODAJ, NASLEDNA PRAVA @ENE*, zbornik vo cest na Vasilev Haci Mile, “Sv.Kiril i Metodij” – Praven fakultet “Justinian Prv”, Skopje; 2004, fq.11.



**Në Venedik dhe Francë** gruaja ka pasur të drejtën e fitimit të mirasit (pasurisë), por jo edhe të drejtën që të jetë trashëgimtare edhe atëherë kur nuk ka pasur meshkuj si trashëgimtar.

**Në Angli** gruaja ka pasur të drejtën në trashëgimi në atë rast kur nuk ka pasur vëllezër, por sërish të drejtat e tyre kanë qenë të kufizuara sepse me lidhjen e martesës kanë humbur pronësinë pasi që ka kaluar nën kontrollin e bashkëshortit siç ka qenë edhe deri atëherë nën kontrollin e babait.

**Në Jug të Francës** poashtu shumë rallë gratë mund të paraqiteshin si trashëgimtare. Në shumë vende Evropiane në periudhën e mesme kjo situatë ka qenë e njëjtë.<sup>33</sup>

Ndikimi i kishës në këtë periudhë për trashëgiminë është i madh, e drejta kanonike e pranon trashëgiminë testamentale si dëshirë e fundit e trashëgimlënësit. Nga mesi i shekullit XIII kisha ka marrë iniciativën për ndarjen e pasurisë, ku sipas të drejtës kanonike pasi që të jenë paguar të gjithë taksat 1/3 e pasurisë i ka takuar fëmijëve, 1/3 bashkëshortit dhe 1/3 për personat bëmires.<sup>34</sup>

### **1.2.2. Pozita e bashkëshortëve jashtmartesorë në periudhën e mesme**

Periudha e mesme është shumë e ndikuar nga religjioni dhe sa i përket bashkësisë jashtmartesore ajo është e ignoruar, e lënë anash nga rrethi por edhe nga ligji.

Është e njohur thënja e Napoleon Bonapartës në Kodin Civil 1804 sipas së cilës *“Les concubins ignorant la loi, le lois les ignore”* që do me thënë bashkëshortët jashtmartesorë e ignorojnë ligjin, edhe ligji i ignoron ato.<sup>35</sup>

---

<sup>33</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследувањето во Европа”*, Скопје, 2011, fq.36-37.

<sup>34</sup> Charls Gross, *The medieval law of intestacy*, Harvard Law Review, Vol. 18, No.2 (1904), fq.120-131, dhe op.cit, fq.37.

<sup>35</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2010, fq.69.

### 1.3. Periudha e re

#### 1.3.1. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Francez

Trashëgimi në Francë ka qenë shumë e ndikuar nga Revolucioni Borgjez Frances i vitit 1789. Vitet 1790 dhe 1804 janë vitet kyçe për zhvillimin e së drejtës trashëgimore. Qëllimi kryesor i revolucionit në sferën trashëgimore ka qenë që të egzistojë barazia mes trashëgimtarëve dhe të anashkalohet bindja shekullore që meshkujt kishin përparësi prej vajzave (pothuajse vajzat nuk llogariteshin në trashëgimi), kurse vëllau më i madh kishte pozitë dominuese para të tjerëve.

Në ligjin e vitit 1793 fëmijët jashtëmartesorë janë barazuar me fëmijët martesorë. Kjo ka qenë e pranuar edhe në Kodin Civil sipas të cilës fëmijët jashtëmartesorë mund të bëhen trashëgimtarë të prindërve të tyre.<sup>36</sup> Nga njëra anë kemi ndryshimin e pozitës së fëmijëve jashtëmartesorë por sa i përket bashkëshortëve jashtëmartesorë në atë sferë nuk ka asnjë ndryshim. Bashkëshortët jashtëmartesorë nuk janë trashëgimtarë të njërit-tjetrit por vetëm kanë të drejta subsidiare që të paraqiten si trashëgimtarë në rast se nuk ka asnjë familjar.<sup>37</sup> Ky ndryshim është pranuar edhe në Kodin Civil 1804. Me këtë akt bashkëshortëve u jepet mundësia të jenë trashëgimtar, por me kusht trashëgimlënësi mos ketë lënë asnjë trashëgimtar ligjor dhe as fëmijë jashtëmartesorë.

Me ndryshimet më të reja në të drejtën Franceze 1972 bashkëshorti i trashëgimlënësit në radhën e parë trashëgon  $\frac{1}{4}$  nga pasuria kur konkuron me fëmijtë jashtëmartesorë. Në rendin e dytë bashkëshorti fiton  $\frac{1}{2}$  e pronësisë. Bashkëshorti martesor i trashëgimlënësit i largon nga trashëgimia trashëgimtarët në rendin e tretë. Përveq kësaj nëse nuk ka asnjë trashëgimtar bashkëshorti ka të drejtë të trashëgojë të gjithë pasurinë trashëgimore.<sup>38</sup>

---

<sup>36</sup>Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.37-44.

<sup>37</sup> По аty, fq.44.

<sup>38</sup>Nenet 731-755, Kodi Civil Francez, dhe Димовска Ана, "Наследно правната положба на брачниот другар во Македонско и компаративно право", 2011, fq.14.

### **1.3.2. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodi i përgjithshëm pasuror Austriak (ABGB)**

Në ligjin civil Austriak (viti 1811) bëhet klasifikimi në bazë të asaj se me kë konkuron bashkëshorti pasjetues. Përderisa konkuron me më pak se 4 fëmijë ose me familjar që llogariten si trashëgimtar ligjor, bashkëshortit i jepet mundësia e  $\frac{1}{4}$  nga pasuria trashëgimore. Si përjashtim në ato rast kur nuk ka asnjë trashëgimtar ligjor, bashkëshorti mund të paraqitet si trashëgimtar.<sup>39</sup>

Pozita e bashkëshortëve përmirësohet pas Novelave të vitit 1914, sipas të cilës bashkëshorti pasjetues kur konkuron me fëmijtë e trashëgimlënësit, pa marrë parasysh numrin e tyre, ajo fiton  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore. Në rastet kur konkuron me prindërit e trashëgimlënësit dhe fëmijtë e tyre bashkëshorti fiton gjysmën e pasurisë trashëgimore. Edhe në rendin e tretë kur konkuron me gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit, bashkëshorti pasjetues fiton gjysmën e pasurisë trashëgimore.<sup>40</sup>

Në ligjin civil Austriak poashtu bashkëshortët jashtëmartesorë nuk janë të përfshirë si trashëgimtarë ligjorë.

### **1.3.3. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Gjerman (BGB)**

Ndryshimet më radikale në Europë në aspektin e përmirësimit të pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve janë bërë në të drejtën civile Gjermane, që prej vitit 1896 marrëdhëniet martesore janë barazuar me gjininë e gjakut, sipas së cilës hyn në rethin e trashëgimtarëve ligjor.

Sipas kodit civil Gjerman, bashkëshorti pasjetues përherë të parë paraqitet si trashëgimtar në **radhën e parë** bashkë me fëmijët e trashëgimlënësit, ku fiton  $\frac{1}{4}$  e trashëgimisë. **Në radhën e dytë**, bashkëshorti konkuron me prindërit e trashëgimlënësit dhe fëmijtë e tyre, sipas së cilës ka të drejtë gjysmën e trashëgimisë. **Në radhën e tretë** të trashëgimisë kur konkuron me gjyshërit dhe gjyshet poashtu i takon gjysma e masës

---

<sup>39</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009, fq.82.

<sup>40</sup> Nenet 731-741, Kodit Civil Austriak dhe Хаџи Василов Вардарски Миле, "Наследно Право", Скопје, 1983, fq.94.

trashëgimore. Në momentin kur nuk ka gjyshër dhe gjyshe, bashkëshorti bashkjetues do të trashëgojë tërë pasurinë trashëgimore.<sup>41</sup>

Situata e fëmijëve jashtëmartesorë në Gjermani ka qenë në pozitë më të volitshme në krahasim me vendet tjera Evropiane. Fëmijët jashtëmartesorë kanë pasur të drejtën e trashëgimisë së nënës të tij dhe të drejtën e mbajtjes nga prindërit e babait në rast të vdekjes.<sup>42</sup> Edhe pse në Gjermani situata e fëmijëve jashtëmartesorë është përmirësuar, kjo situatë nuk vlen edhe për bashkëshortët jashtëmartesorë. Për to ende nuk egzistojnë rregulla që të paraqiten si trashëgimtar ligjor.

#### **1.3.4. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Zvicëran**

Sipas të drejtës civile Zvicëran, bashkëshorti paraqitet si trashëgimtar në tre radhë. Karakteristike për pozitën e bashkëshortëve në trashëgimi është se në dy radhët e para ato kanë të drejtën në zgjidhje ose të trashëgojnë masë më të vogël të pronësisë ose masë më të madhe të pronësisë, por në emër të mbajtjes së përhjetshme.<sup>43</sup>

Në rastet kur bashkëshorti konkuron me trashëgimtarët e **radhës së parë**, bashkëshorti mund të trashëgojë  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore, ose të fitoj  $\frac{1}{2}$  e trashëgimisë në emër mbajtje e përhjetshme.

**Në radhën e dytë** bashkëshorti trashëgon  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore ose  $\frac{3}{4}$  e trashëgimisë si mbajtje e përhjetshme.

**Në radhën e tretë** bashkëshorti fiton  $\frac{1}{2}$  nga trashëgimia dhe masën tjetër si mbajtje e përhjetshme.<sup>44</sup> Në rast se nuk ka asnjë trashëgimtar ligjor, bashkëshorti fiton tërë pasurinë trashëgimore.<sup>45</sup>

---

<sup>41</sup>Nenet 1924-1930, Kodi Civil Gjerman dhe Трпеновска - Спиоровиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009, fq.83-84.

<sup>42</sup> Трпеновска - Спиоровиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.44.

<sup>43</sup> Антиќ Б. Оливер, "Наследно право", Београд, 2001, fq.106.

<sup>44</sup> По ату, fq.107, dhe Трпеновска - Спиоровиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009, fq.86.

<sup>45</sup> Neni 462, pika 1 dhe 2, Kodi Civil Zvicran

### **1.3.5. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sipas Kodit civil Italian**

Sipas kodit civil Italian të vitit 1942, bashkëshorti nëse konkuron me fëmijët e trashëgimlënësit ka të drejtën e uzurfruktit në 1/3 e trashëgimisë, edhe atë nëse konkuron me një fëmi gjysmën kurse nëse konkuron me më shumë fëmijë atëherë fiton 1/3 e trashëgimisë. Poashtu edhe në radhët e tjera bashkëshorti paraqitet si trashëgimtar dhe masa e pasurisë varet nga ajo se me kë konkuron në këto radhë.<sup>46</sup>

Nëse konkuron me fëmijët jashtëmartesorë fiton 1/3 e trashëgimisë, gjysmën nëse konkuron me vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit, ¼ nëse konkuron me kushërinjtë anësorë kurse bashkëshorti mund të fitojë edhe të gjithë pasurinë nëse nuk ka asnjë tjetër trashëgimtar ligjor.<sup>47</sup>

---

<sup>46</sup> Pjesa e dytë, Kodi Civil Italian.

<sup>47</sup> Благојевик Т. Борислав, *op.cit*, fq.133.

#### 1.4.Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve në të drejtën Islame

E drejta e Sheriatit është zhvilluar në bazë të njohrive nga e drejta zakonore e shteteve arabe paraislamike. Sheriati, siç quhet e drejta islamike, është kompleksitet i ligjeve hyjnore që myslimani i zellshëm i respekton nëse ai kërkon t'i zbatojë detyrat e fesë.<sup>48</sup>

E drejta islame është e drejtë që drejton (qeveris) ithtarët e religjionit islam. Burimet kryesore të së drejtës myslimane janë: Kurani, Suna, Ixhma dhe Kizhas. Kurani merret burim ligjor, burim i parë i të drejtës myslimane dhe pas Kuranit mund të numërohen burimet tjera.<sup>49</sup>

Në Kuran për të drejtën civil ka 70 ajete pra Kurani është tërrësi e dispozitave. Në librin e shenjtë kryesisht i kushtohet kujdes të drejtës familjare, trashëgimore, penale dhe të drejtës së luftës. Dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën gjenden të shpërndarë nëpër suret e ndryshme.<sup>50</sup>

E drejta e Sheriatit, e cila u zbatua një kohë të gjatë në territorin e Maqedonisë dhe më gjerë, depërtoi në vëmendjen e popullit. Sheriati pati ndikim edhe në të drejtën zakonore.<sup>51</sup>

Familja sipas së drejtës islame është celulë themelore e shoqërisë në përgjithësi, dhe si e tillë në të drejtën Islame i është kushtuar një ndër vendet më të rëndësishme në shoqërinë njerëzore, për këtë arsye edhe në burimin kryesor të së drejtës Islame, Kur'anin, në shumë ajete flitet për rëndësinë e familjes, gruas, fejesës, martesës, trashëgimisë duke marrë parasysh që edhe një kaptinë e tërë mban emrin Nisa që do të thotë gratë. Juristët islam në bazë të burimit primar të së drejtës Islame, Kur'anit, si dhe burimi sekondar të së drejtës Islame kanë përpiluar rregullat për institucionin e martesës e cila është bazament i krijimit, zhvillimit, harmonisë, mbijetesës, ruajtjes dhe forcimit të familjes si faktor themelor për ruajtjen dhe zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë.<sup>52</sup>

---

<sup>48</sup> Aliu Abdulla, "e drejta civile", Prishtinë 2013, fq.137

<sup>49</sup> Po aty, fq.138.

<sup>50</sup> Po aty, fq.138.

<sup>51</sup> Po aty, fq.139.

<sup>52</sup> <http://www.mediaelire.net/lajm/1038/martesa-sipas-drejtës-islame/>, (27.08.2018).

Me martesë në të drejtën e shariatit nënkuptojmë: *“Kontratën me rastin e lidhjes së kurorës, me të cilën mashkullit i lejohej të frimë seksual me femrën, nëse nuk ka ndonjë pengesë ligjore që pengon lidhjen e saj”*<sup>53</sup> Martesa urdhërohet në burimin kryesor të së drejtës islame, në Kur’an në surën e katërt Nisa (Gratë) në ajetin e tretë : *“martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e nëse frikësohuni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua”*. *“Juristët islam e definojnë martesën si kontratë martesore të arritur në mes burrit dhe gruas me ç’rast fitojnë të drejtën ligjore të jetojnë në marrëdhënie intime”*.<sup>54</sup>

Në terminologjinë e së drejtës Islame, e drejta e trashëgimisë njihet me emrin *“Ilmul Mirath”*. Shkenca e trashëgimisë, e cila merret me studimin e dispozitave juridike për bartjen e pasurisë pas vdekjes fizike të dekojuesit (*trashëgimlënësit*) dhe gjendjen e suksesorëve (*trashëgimtarëve*). Nocioni *“Mirath”* në aspektin gjuhësor ka dy kuptime; lënie, mbetje dhe bartje e një sendi nga një person te personi tjetër, ose nga një popull te populli tjetër.<sup>55</sup>

Dispozitat dhe normat e së drejtës së trashëgimisë në Kur’anin famëlartë janë të parqitur në dy mënyra:

1. Dispozitat e trashëgimisë të përfshira në mënyrë globale dhe universale duke i dhënë të drejtë juridike trashëgimtarit për trashëgimi, por duke mospërcaktuar në mënyrë të prerë sasinë e trashëgimit të tij, e këtë e argumentojnë ajetet e poshtëshënuara:
  - *“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti). Kur të prezentojnë (në pjestimin e pasurisë që ka lënë i vdekuri) të afërmëve, bonjakëve dhe varfanjakëve (që nuk janë pjestarë në trashigimi), jepuni nga ajo (pasuri e lënë) dhe atyre thuajuni fjalë të mira”*.<sup>56</sup>

<sup>53</sup> <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=128>, (27.08.2018).

<sup>54</sup> <http://www.mediaelire.net/lajm/1038/martesa-sipas-drejtës-islame/>,(27.08.2018).

<sup>55</sup> <http://jusufzimeri.com/e-drejta-e-trashegimise/>, (27.08.2018).

<sup>56</sup> Po aty, (27.08.2018).

2. Dispozitat e trashëgimisë me përpikshmëri përcaktojnë trashëgimtarin dhe sqarojnë sasinë që i takon çdo trashëgimtari nga pasuria e lënë dhe se askush nuk ka të drejtë ta pengojë në atë që i takon. Ajetet që përfshijnë dispozitat e sqaruara në detaje të cilat në vazhdim paraqesim sipas zbritjes së tyre janë:

- *“All-llahu ju urdhëron për (çështen e trashigimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra; nëse janë (trashëgimtare) vetëm femra, dy e më shumë, atyre ju takojnë dy të tretat e pasurisë që trashëgohet; nëse është një femër, asaj i takon gjysma; për prindërit, për seclin nga ata, ju takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri) nëse ka fëmijë; e në qoftëse (i vdekuri) nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë (vetëm) prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta; në qoftë se ai (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta, (kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet (vasijjeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borgji; ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj. (Ky përcaktim është) Urdhër nga Allahu. Vërtet Allahu është më i Dijshmi, më i Urti”.*<sup>57</sup>
- *“Juve u takon gjysma e asaj (pasurie) që e lënë gratë e tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë, por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta nga ajo që lënë ato, pasi të kryhet testamenti i tyre dhe pasi të lahet borgji. Atyre (grave) ju takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë, atyre ju takon një e teta nga ajo që leni pas kryrjes së testamentit qëkeni përcaktuar ose borxhit. Në qoftë se (i vdekuri) është mashkull ose femër, e trashëgohet nga ndnjë ilargët (pse s’ka as prindër as fëmijë) po ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta, e në qoftëse sejanë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë), pas testamentit të porositur ose borxhit, e duke mos dëmtuar (trashëguesit). Ky përcaktim është porositur prej Allahut. All-llahu është i gjithëdijshmi, jo ingutshëm.”*<sup>58</sup>

Nga studimet e bëra për të drejtën islame mund të konkludojmë se dispozitat e përfshira në librin e shenjtë islam Kuranit janë dispozita më të sofistikuara, ku rëndësi të madhe i është kushtuar gruas, në Kuran vërejmë se edhe gratë kanë të drejtë në trashëgimi ne krahasim me të drejtat e tjera ku ende nuk e kanë të zhvilluar trashëgiminë tek gratë.

<sup>57</sup> <http://jusufzimeri.com/e-drejta-e-trashegimise/>, (27.08.2018).

<sup>58</sup> Po aty, (27.08.2018).



## KAPITULLI II

### 2. Zhvillimi historik të pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë dhe jashtmartesorë në Republikën e Maqedonisë

#### 2.1. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1955

Themelet e së drejtës moderne trashëgimore në Republikën e Maqedonisë janë bërë me sjelljen e Ligjit për trashëgimi të vitit 1955.<sup>59</sup>

Ligji për trashëgimi i vitit 1955 bazohet në principet vijuese:

- ❖ Rregullimi unik i trashëgimisë
- ❖ Barazia e qytetarëve në trashëgimi
- ❖ Ligji dhe testamenti si bazë përfundimtare për thirje në trashëgimi
- ❖ Efekti retroaktiv i Ligjit për trashëgimi
- ❖ Procedura trashëgimore si pjesë përbërëse e ligjit për trashëgimi<sup>60</sup>

Ligji federal për trashëgimi parashikon 4 rنده për trashëgimi, me mundësi që të egzistojë edhe rendi i pestë dhe rنده të tjera. Rethi i personave që do të trashëgojnë në këto rنده trashëgimore varej nga lidhjet familjare dhe martesore.

Pozita e bashkëshortit si trashëgimtar ligjor është përmirësuar. Kështu që në rendin e parë pjesa trashëgimore e bashkëshortit është e barabartë me pjesën e fëmijëve, kurse në rendin e dytë pjesa trashëgimore e bashkëshortit është gjysma e pasurisë trashëgimore.<sup>61</sup> Përveq këtyre ndryshimeve, ligji i vitit 1955 parashikon mundësinë e zvogëlimit apo rritjen e masës trashëgimore të trashëgimtarëve.<sup>62</sup>

Me ligjin për trashëgimi të vitit 1955 pozita e bashkëshortëve është përmirësuar në pjesën e domozdoshme. Shikuar në aspektin e madhësisë së pjesës së domozdoshme, ajo është e barabartë me pasardhësit e trashëgimtarëve pjesa e domozdoshme e të cilëve është

---

<sup>59</sup> *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, Службен весник на Република Македонија, nr.20/55, dhe Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.47.

<sup>60</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2010, fq.13.

<sup>61</sup> По аty, fq.13.

<sup>62</sup> По аty, fq.13.

gjysma e pjesës ligjore. Me këtë ligj poashtu është përmirësuar edhe pozita e fëmijëve jashtëmartesorë, të cilëve u është njohur pjesë e barabartë e trashëgimisë me fëmijët trashëgimlënësit por në qoftë se babai ka njohur fëmiun jashtëmartesorë, apo e ka marrë të jetojë me të, apo në një mënyrë tjetër ka njohur fëmiun.<sup>63</sup>

Me këtë ligj kemi përmirësimin e pozitës së bashkëshortëve msrtesorë, fëmijëve jashtëmartesorë por jo edhe të bashkëshortit jashtëmartesorë. Kjo ndosh për shkak se ende nuk egzistojnë kushte për përfshirjen e një partneri jashtëmartesorë në rendin e trashëgimtarëve ligjor.

---

<sup>63</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2010, fq.14.

## 2.2. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1973

Ligjit për trashëgimi i vitit 1973 është ligji i parë i Republikës së Maqedonisë për trashëgimi. E drejta trashëgimore në Republikën Socialiste të Maqedonisë rregullohet me dispozitat e këtij ligji (neni 1).<sup>64</sup>

Me sjelljen e ligjit të vitit 1973, ligji për trashëgimi i vitit 1955 pushoi të vlejë në pjesën materiale, kurse në pjesën e proceduarave trashëgimore vazhdon të vlejë edhe më tej. Marrëdhënjet familjare dhe martesore vazhdojnë edhe më tej të jenë faktorët kryesor mbi bazën e të cilëve janë ndërtuar të drejtat për rendet trashëgimore ligjore.

Me këtë ligj erdhi deri në përmirësimin e mëtejshëm të pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve. Me ligjin e vitit 1973 është parashikuar mundësia që bashkëshorti të paraqitet si trashëgimtar i vetëm, në rendin e parë nën kushte të caktuara ligjore (neni 135).

Bashkëshorti si trashëgimtar ligjor i pasurisë trashëgimore të bashkëshortit të tij/saj, paraqitet në formën e suksesorit universal, e jo si më parë që kishte vetëm të drejtën e uzurfruktit. Pjesa trashëgimore e bashkëshortit varej se në cilin rend gjendet dhe me kë konkuron. Si rregull, pjesa trashëgimore e bashkëshortit pasjetues është e barabartë me pjesën trashëgimore të të afërmeve të tjerë, me të cilët ka konkuruar.

Sipas kësaj, madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit që konkuron me pasardhësit e trashëgimlënësit mvarej nga numri i fëmijëve, të cilët konkurojnë në të njëjtin moment. Pjesa e bashkëshortit kur ka më pak fëmijë mund të jetë më i madh por jo më shumë se gjysma e pasurisë.<sup>65</sup> Egzistojnë tre rende ligjore trashëgimore.

Si në ligjet e mëparshme ashtu edhe në këtë ligj është parashikuar mundësia e zvogëlimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit (neni 13). Rritja e pjesës trashëgimore të bashkëshortit (neni 25), por edhe rritjen e pjesës trashëgimore të prindërve kur konkuron me bashkëshortin, në ato raste kur janë thirrë në trashëgimi (neni 26). Me këtë ligj është parashikuar mundësia që bashkëshorti të mund të trashëgojë e gjithë pasurinë trashëgimore, në rastet kur nuk ka trashëgimtar tjetër.<sup>66</sup>

---

<sup>64</sup> Neni 1, *Ligji për trashëgimi*, *Службен весник на СРМ*, nr.35/73.

<sup>65</sup> *Ligji për trashëgimi*, *Службен весник на СРМ*, nr.35/73.

<sup>66</sup> По аты, neni 17.

### 2.3. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve sipas Ligjit për trashëgimi të vitit 1996

Burimi kryesor për të drejtën trashëgimore në Republikën e Maqedonisë, që nga fillimi i saj e deri më sot është Ligji për trashëgimi<sup>67</sup> e sjellur në shtator të vitit 1996.

Ligji për trashëgimi që ka sjell Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (1996) është ndërtuar me të njëjtat parime si edhe ligji i mëparshëm i trashëgimisë i vitit 1973 (“Службен весник на СРМ” nr.35/73, 27/78) dhe ligji për trashëgimi i vitit 1955 (“Службен лист на СФРЈ” nr.20/55, 12/65) teksti i pastruar i të cilit është botuar në vitin 1965 (“Службен лист на СФРЈ”, nr.42/65).

Parimet kryesore janë: parimi i barazisë në rregullat trashëgimore, barazia e qytetarëve në trashëgimi, barazia e bashkëshortëve martesorë me bashkëshortët jashtmartesorë dhe të adoptimit me gjininë e gjakut.

Si bazë për thirje në trashëgimi janë: ligji dhe testamenti, kurse faktorët kryesorë mbi të cilën janë ndërtuar rendet trashëgimore ligjore janë: lidhjet prindërore dhe martesore. Është paraparë sistemi parenteral-linear (e drejta e përfaqësimit) për thirjen e trashëgimtarëve në trashëgimi e cila bazohet në bazë të vijave dhe parentelave. Egzistojnë tre rende ligjore kurse në rastet kur nuk ka trashëgimtar trashëgimia i takon Republikës së Maqedonisë.<sup>68</sup> Ligji për trashëgimi i vitit 1996 është ligj që vlen ende në ditët e sotme, një ligj gjithpërfshirës por që ka nevojë për disa ndryshime dhe plotësime.

---

<sup>67</sup> *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, Службен весник на Република Македонија, nr.47/96.

<sup>68</sup> Чавдар Кирил, “Коментар на Законот за наследувањето” Агенција академик, Скопје, 1996, fq.3.

## KAPITULLI III

### 3.Baza juridike e thirjes në trashëgim

Që në kohërat e lashta janë të njohura dy bazat e thirjes në trashëgim, ajo në bazë të ligjit dhe në bazë të testamentit. Poashtu sipas Ligjit për trashëgim të Republikës së Maqedonisë neni 6 thuhet se: *“mund të trashëgohet në bazë të ligjit dhe në bazë të testamentit”*. Trashëgimi është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë së trashëgimlënësit trashëgimtarëve të tij. Trashëgimia me ligj ka vend kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament.<sup>69</sup>

- ❖ **Trashëgimi në bazë të ligjit** vjen në shprehje atëherë kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërsisht ose pjesërisht i pavlefshëm.<sup>70</sup>
- ❖ **Testament** do të thotë shprehje e vullnetit të fundit të dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashëgimlënësi urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij edhe pas vdekjes së tij.<sup>71</sup>

Në literature juridike shumica e autorëve në grupin e faktorëve që përcaktojnë radhët e trashëgimit ligjor përmendin: *gjininë dhe llojet e saj* përfshirë gjininë e gjakut, martesore, jashtmartesore, adoptimin.

Në të drejtën trashëgimore maqedonase faktet për caktimin e trashëgimtarëve janë:

1. Gjinia
2. Bashkësia martesore
3. Jetesa e përbashkët<sup>72</sup>

---

<sup>69</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, *“E drejta trashëgimore”*, Prishtinë, 2007, fq.49.

<sup>70</sup> По ату, fq.50.

<sup>71</sup> По ату, fq.88.

<sup>72</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследно право”*, Скопје, 2016, fq.106.

### 3.1. Gjinia si fakt për caktimin e radhëve ligjore të trashëgimit

Gjinia është një marrëdhënje e pranuar ligjërisht midis dy ose më shumë personave në bazë të së cilëve lindin të drejta dhe detyrime të caktuara. Gjinia është lidhja më e vjetër dhe ende më e rëndësishme midis trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve të tij ku formohet rrethi i trashëgimtarëve ligjor.

Në të drejtën tonë janë të njohura tre lloje të gjinisë: 1. Gjinia e gjakut, 2. Gjinia e krushqisë dhe 3. Gjinia e birësimit.<sup>73</sup>

#### ➤ Gjinia e gjakut

Gjinia e gjakut është lidhje prej gjaku që krijohet mes dy ose më shumë personave që rrjedhin njëri prej tjetrit ose prej një të paralinduri të përbashkët. Kjo është lidhje natyrore sepse krijohet me lindje. Bazë e krijimit të gjinisë është lindja e fëmijëve në martesë ose në bashkësinë jashtmartesore.<sup>74</sup>

Duke rrjedhur njëri prej tjetrit midis persova krijohen vija dhe shkalla që shërbejnë për matjen e afërisisë në gjini. Janë të njohura dy lloje vijash të gjinisë: vijë e drejtë (line recta) dhe vijë e tërthortë (anësore). **Vijë e drejtë** gjini mund të jetë ngritëse (p.sh djali, ati, gjyshi, stërgjyshi) dhe *zbritëse* (p.sh. stërgjyshi, gjyshi, ati, djali). Në **vijën e tërthortë** qëndrojnë persona që janë në gjini gjaku, për shkak se rrjedhin prej një të paralinduri të përbashkët, qoft ky ati, nëna ose të dy sëbashku. Në vijë të tërthortë në gjini qëndrojnë: vëllezërit, motrat, kushërinjtë dhe nipi. Vija e tërthortë mund të jetë *e plotë*, po që se të afërmit gjini rrjedhin nga ati dhe nëna e njejtë ose nga gjyshi dhe gjyshja e njejtë. *Vijë e tërthortë gjini jo e plotë* është e kundërta e saj. Kjo formohet atëherë kur të paslindurit e kanë të përbashkët vetëm njërin prind.<sup>75</sup>

#### ➤ Gjinia e krushqisë

Gjinia e krushqisë (affinitas) është lidhje që krijohet midis njërit bashkëshort me të afërmit gjini gjaku të bashkëshortit tjetër. Bazë e vetme e krijimit të kësaj gjinie është martesë.

<sup>73</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследно право", Скопје, 2016, fq.107.

<sup>74</sup> Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2005, fq.50.

<sup>75</sup> По аты, fq 50 dhe 51.

Gjinia e krushqisë është e përhershme. Edhe kur pushon martesë, qoftë me anulim ose me zgjidhjen e saj, gjinia e krushqisë nuk pushon së egzistuari, por ajo vazhdon të egzistojë edhe më tej midis njërit bashkëshort dhe personave gjini gjaku të bashkëshortit tjetër.

Bazë e krijimit të gjinisë së krushqisë nuk mund të jetë bashkësia jashtmartesore sepse për tu krijuar gjinia e krushqisë duhet patjetër të ketë egzistuar martesë, në bazën e të cilëve edhe është krijuar ajo.<sup>76</sup>

➤ Gjinia e birësimit (gjinia civile)

Gjinia e birësimit krijohet me akt juridik midis birësuesit dhe të birësuarit. Me dallim nga gjinia e gjakut e cila krijohet në mënyrë natyrore me lindje, gjinia e birësimit formohet në mënyrë juridike me lidhjen solemne dhe formale të kontratës, prandaj shpesh quhet edhe gjini e krijuar në mënyrë artificiale.<sup>77</sup> Marrëdhëniet që krijohen me birësim janë të ngjajshme me marrëdhënjet midis prindërve dhe fëmijëve.

---

<sup>76</sup> Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2005, fq 54 dhe 55.

<sup>77</sup> Po aty, fq.56.

### 3.2. Lidhja martesore si fakt për caktimin e trashëgimtarëve

Në të drejtën trashëgimore të Republikës së Maqedonisë, përveç gjinisë edhe lidhja martesore është një fakt vendimtar në përcaktimin e rethit të trashëgimtarëve ligjor dhe për formimin e radhëve trashëgimore.

Sipas ligjit për familje *“Martesa është bashkësi jetese mes një burri dhe gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë”*<sup>78</sup>

Me lidhjen e martesës, bashkëshortët përveç të drejtave dhe detyrime të tjera familjare, fitojnë të drejtën e trashëgimisë ligjore.

Në të drejtën tonë bashkëshorti paraqitet si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit (bashkëshortit të vdekur) në radhën e parë dhe të dytë të trashëgimisë.<sup>79</sup>

### 3.3. Jetesa e përbashkët

Faktori i tretë në bazën e të cilës përcaktohet rethi i personave që paraqiten si trashëgimtar ligjor është edhe jetesa e përbashkët. Ky faktor shumë rallë është i pranuar në praktikë.<sup>80</sup>

Ligjdhënësi taksativisht i numëron personat të cilët kanë të drejtë në trashëgimi sipas këtij faktori. Ato janë: i ushqyeri dhe ushqyesi, thjeshtri dhe thjeshtra, njerku dhe njerka, reja dhe vjehri dhe vjehra, dhëndri dhe gjyshi dhe gjyshja dhe personat që janë në gjini gjaku që kanë jetuar ne bashkësi të vazhdueshme, reciprokisht trashëgon me kusht që i vdekur mos ketë lënë bashkëshort dhe trashëgimtar të tjerë të rendit të parë dhe prindër dhe vëllezër dhe motra. Në këtë rast këto persona e trashëgojnë tërë masën trashëgimore në pjesë të barabarta.<sup>81</sup>

Këto persona të numëruar me ligj trashëgojnë në radhën e dytë të trashëgimisë me kusht që të jetojnë në një bashkim të përhershëm për 5 vite.

---

<sup>78</sup> Neni 6, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.80/92.

<sup>79</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследно право”*, Скопје, 2016, fq.112.

<sup>80</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследно право”*, Скопје, 2016, fq.114.

<sup>81</sup> Neni 29, paragrafi 1, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.



## **4. Radhët e trashëgimisë sipas ligjit për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë**

Sipas nenit 12 të ligjit për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë të vdekurin e trashëgojnë: të gjithë të paslindurit e tij, të adoptuarit e tij dhe të paslindurit e tyre, bashkëshorti/ja e tij/saj, adoptuesit e tij, prindërit e tij, motrat dhe vëllezërit e tij dhe të paslindurit e tyre dhe gjyshërit dhe gjyshet e tij dhe të paslindurit e tyre.

Këto persona trashëgojnë sipas rrethëve trashëgimore. Trashëgimtarët e rendit më të afërm të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e rendit më të largët të trashëgimisë.<sup>82</sup>

Në legjislacionin tonë egzistojnë tre radhë të trashëgimisë. Radha ligjore e trashëgimisë cakton përparësinë midis trashëgimtarëve ligjor.

### **4.1. Bashkëshorti/ja në redin e parë të trashëgimisë**

Sipas nenit 13 të Ligjit për trashëgimi “masën trashëgimore të të vdekurit e trashëgojnë para se gjithash fëmijët e tij dhe bashkëshorti/ja e tij/saj. Ata trashëgojnë pjesë të barabarta”<sup>83</sup>

Me termin fëmijë në të drejtën tonë trashëgimore është përhapur gjerësisht dhe interpretohet (përfshin) fëmijët e lindur në martesë, fëmijët e lindur në bashkësinë jashtëmartesore si dhe fëmijët e adoptuar.

Në lidhje me trashëgiminë bashkësia jashtëmartesore barazohet me bashkësinë martesore, ndërsa gjinia e krijuar me adoptim të plotë me gjininë e gjakut. Për të mundur fëmijët jashtëmartesorë të realizojë të drejtën në trashëgimi ndaj babait jashtëmartesorë është e domosdoshme që bashkësia jashtëmartesore të jetë vërtetuar në mënyrë të përcaktuar me ligj. (neni 4 i Ligjit për trashëgimi)<sup>84</sup>

---

<sup>82</sup> Neni 12, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>83</sup> Neni 13, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96 .

<sup>84</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследно право”, Скопје, 2016, fq.129-130.

Nëse trashëgimlënësi ka lënë pas vete djalin (A), vajzën (B) dhe bashkëshortin (C), sipas ligjit për trashëgimi në fuqi që të tre këtyre trashëgimtarëve do t'ju takojë 1/3 e vlerës së përgjithshme të pasurisë trashëgimore.<sup>85</sup>

Bashkëshorti i trashëgimlënësit paraqitet si trashëgimtar në radhën e parë të trashëgimisë vetëm nëse ka së paku një pasardhës që do të trashëgojë me të. Në rastet kur nuk ka pasardhës, as fëmijë të adoptuar e as pasardhësit e tyre, bashkëshorti/ja bëhet trashëgimtar/e i rendit të dytë të trashëgimisë.<sup>86</sup>

Megjithatë egziston mundësia që bashkëshorti/ja të jetë trashëgimtar i gjithë masës trashëgimore, në rastet kur trashëgimtarët e rendit të parë pasardhësit, adoptuesit me pasardhësit e tyre kanë hequr dorë nga trashëgimia.<sup>87</sup>

Përveç bashkëshortit, fëmijët e trashëgimlënësit fillimisht thiren në trashëgimi. Kushti që duhet të përmbushet sipas ligjit është që fëmija të jetë i gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe të jenë të denjë për trashëgimi.<sup>88</sup>

Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë në vend të tij hyjnë me **të drejtë të përfaqësimit**- fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqe të parapara me ligj nuk mund të jenë trashëgimtar p.sh. për shkaqe të padenjësisë për trashëgim atëherë hyn në trashëgim të paslindurit e tyre.<sup>89</sup>

Sipas Ligjit për trashëgim "Pjesa e masës trashëgimore që i ka takuar fëmijës së vdekur më parë nëse do ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij, nipërit e trashëgimlënësit, në pjesë të barabarta, ndërsa nëse ndonjëri nga nipërit ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë pjesa që do t'i kishte takuar po të kishte qenë gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij, stërnipërit e trashëgimlënësit, në pjesë të barabarta dhe kështu me radhë derisa ka të paslindur të trashëgimlënësit"<sup>90</sup>

---

<sup>85</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2007 fq.62.

<sup>86</sup> Горѓиевиќ Братислав, Сворцан Слободан, "Наследно право", савремена администрација, Београд, 1992, fq.140.

<sup>87</sup> Neni 128, paragrafi 6, Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.47/96 .

<sup>88</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009, fq.109.

<sup>89</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2007, fq.62.

<sup>90</sup> Neni 14, Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.47/96.

P.sh. nëse trashëgimlënësi ka lënë pas vete bashkëshorten dhe dy fëmijë të martuar të cilët gjithashtu kanë fëmijë që në fakt janë nipat dhe mbesat e trashëgimlënësit atëherë këta (nipat dhe mbesat e trashëgimlënësit) do të trashëgojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që do i takonte prindit të tyre sikur të ishte gjallë në bazë të së drejtës së përfaqësimit.

Me këtë rast duhet theksuar se konsiderohen të barabartë në trashëgim fëmijët martesorë me ato jashtmartesorë si dhe të adoptuarit.<sup>91</sup>




Fig.1.

Mund të vërejmë se bashkëshorti në radhën e parë të trashëgimisë konkuron me fëmijët martesorë, jashtmartesorë apo të adoptuar pjesa e së cilës është e barabartë me pjesën e fëmijëve. Pasuria ndahet aq pjesë sa edhe trashëgimtarë ka, barabart fëmijët me bashkëshortin/ten.

Nëse nuk ka trashëgimtar ligjor në radhën e parë atëherë vije në shprehje trashëgimi ligjor në bazë të radhës së dytë.

#### 4.1.1. Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radhën e parë të trashëgimisë

Në bazë të ligjit vetëm bashkëshorti martesorë mund të paraqitet si trashëgimtar i pasurisë trashëgimore kurse për bashkëshortin jashtëmartesorë nuk egziston asnjë e drejtë trashëgimore.<sup>92</sup>

<sup>91</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2007, fq.63.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për trashëgimi, në radhën e parë pasuria trashëgimore ndahet në aq pjesë sa ka edhe fëmijë trashëgimlënësi (martesore, jashtmartesore, të adoptuar) dhe plus bashkëshorti i trashëgimlënësit.

Në rastet kur trashëgimlënësi ka dy vajza, një djalë dhe bashkëshorti/ja, pasuria trashëgimore do të ndahet në 4 pjesë të barabarta sipas së cilës çdonjë do të fitojë  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore.




Fig.2.

Në qoftë se një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e tij do ta trashëgojnë fëmijët e tij (nipërat apo mbesat e trashëgimlënësit) me të drejtë të përfaqësimit.<sup>93</sup>

Sipas kësaj sa më shumë fëmijë që ka trashëgimlënësi aq më e vogël është pjesa trashëgimore e trashëgimtarëve.

Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radhën e parë en më shumë mund të jetë  $\frac{1}{2}$  e pasurisë edhe atëherë kur konkuron vetëm me një fëmijë të trashëgimlënësit.




Fig.3.

<sup>92</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследното право во Република Македонија", Скопје, 2010, fq.143.

<sup>93</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009, fq.110.

Egziston mundësia që bashkëshorti të fitoj tërrë pasurinë trashëgimore, kjo ndodh në ato raste kur fëmijët e trashëgimlënësit apo trashëgimtarët e tjerë (nipat, mbesat) kanë hequr dorë nga trashëgimia.<sup>94</sup>

#### **4.1.2. Zvogëlimi i pjesës trashëgimore të bashkëshortit në radhën e parë të trashëgimisë**

Në të drejtën trashëgimore të Republikës së Maqedonisë është pranuar koncepti i fleksibilitetit të pjesëve trashëgimore. Kështu që nga rregulla që në rendin e parë trashëgimtarët trashëgojnë në pjesë të barabarta egziston përjashtim.<sup>95</sup>

Nëse bashkëshortja konkuron në radhën të parë të trashëgimit ligjor ajo trashëgon së bashku me fëmijët e trashëgimlënësit ashtu që asaj i takon vetëm një pjesë e pasurisë trashëgimore që është e barabartë me secilën pjesë të secilit fëmijë të trashëgimlënësit. Mirëpo, përjashtimisht bashkëshortes mund t'i zvogëlohet pjesa e pasurisë trashëgimore.

Së pari pjesa e pasurisë trashëgimore i zvogëlohet nëse ajo konkuron me fëmijët e trashëgimlënësit të cilët nuk janë edhe fëmijët e saj dhe së dyti nëse pasuria që e ka bashkëshortja vlen më shumë se sa pjesa e cila do ti takoj asaj në bazë të trashëgimisë.<sup>96</sup>

Sipas Ligjit për trashëgimi neni 15 thuhet se: “kur trashëgimlënësi ka fëmijë të cilët nuk janë nga kurorëzimi me bashkëshortin pasjetues, ndërsa pasuria e këtij bashkëshorti është më e madhe nga pjesa që do të kishte takuar me ndarjen e masës trashëgimore në pjesë të barabarta, atëherë secilit fëmijë të trashëgimlënësit e takon pjesa dy herë më e madhe nga e bashkëshortit”<sup>97</sup>

Që të vijë deri në zvogëlimin e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në favor të fëmijëve duhet të plotësohen dy kushte:

- ❖ Si trashëgimtar në rendin e parë së bashku me bashkëshortin konkurojnë fëmijët e trashëgimlënësit të cilët nuk janë edhe fëmijët e bashkëshortit pasjetues. Si fëmijë të trashëgimlënësit në këtë rast janë fëmijët nga martesë e mëparshme, fëmijët e lindur në bashkësinë jashtmartesore, fëmijët e adoptuar dhe fëmijët e lindur në martesë me bashkëshortin pasjetues.

<sup>94</sup> Neni 128, paragrafi 6, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>95</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследно право”, Скопје, 2016,, fq.134.

<sup>96</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, “E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2007, fq.76.

<sup>97</sup> Neni 15, *Ligjit për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

- ❖ Pasuria që e ka bashkëshorti pasjetues vlen më shumë se sa pjesa e cila do ti takonte asaj në bazë të trashëgimit.<sup>98</sup>

Në qoftë se përmbushen këto dy kushte atëherë gjyqi në ndarjen e trashëgimisë do ti merr parasysh të gjithë rrethanat, dhe të gjithë fëmijëve (pa marr parasysh nga cila bashkësi martesore apo jashtmartesore rrjedh) do ti ndajë dy here më shumë pjesë se sa e bashkëshortit.<sup>99</sup>

Kjo dispozitë zbatohet me kërkesën e fëmijëve të trashëgimlënësit, prindi i të cilëve nuk është bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit, kurse fëmijët prindi i të cilit është bashkëshorti pasjetues nuk mund të realizojë këtë të drejtë. Kjo bëhet me qëllim që të mbrohen fëmijët qoft jashtëmartesorë apo të adoptuar.<sup>100</sup>

Në këtë process, gjykata gjatë vlerësimit do ta dyfishojë numrin e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe duke plotësuar një pjesë të bashkëshortit, gjykata do ta ndajë trashëgiminë.<sup>101</sup>

P.sh. nëse trashëgimlënësi ka dy vajza nga bashkësia e mëprashme martesore dhe bashkëshorten, në këtë rast çdonjëra nga vajzat do ta fitoj nga 2/5 e trashëgimisë kurse bashkëshortja pasjetuese do ta fitoj 1/5 e pasurisë trashëgimore.<sup>102</sup>




Fig.4.

Nga kjo mund të konkludojmë se pozita e bashkëshortit në rendin e parë të trashëgimisë është më në disfavor sesa e fëmijëve. Kjo vjen për arsye se pjesa e

<sup>98</sup> Хаџи Василев Вардарски Миле, “Наследно Право”, Скопје, 1983, fq.39.

<sup>99</sup> Propozimi 2 - neni 15, *propozim nga trashëgimtari për zvogëlimin e pjesës së bashkëshortit të trashëgimlënësit.*

<sup>100</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2010, fq.173.

<sup>101</sup> Хаџи Василев Вардарски Миле, “Наследно Право”, Скопје, 1983, fq.123.

<sup>102</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследно право”, Скопје, 2016, fq.135.

bashkëshortit në rendin e parë të trashëgimisë mund të zvogëlohet e jo edhe të rritet. Egzistojnë tendenca që pjesa e bashkëshortit në rendin e parë të trashëgimisë të zmadhohet në krahasim me fëmijët.

#### 4.2. Bashkëshortja/i në rendin e dytë të trashëgimisë

Në radhën e dytë të trashëgimit ligjor trashëgojnë prindërit dhe bashkëshorti/ja e trashëgimlënësit. Pra, nëse ndodh që trashëgimlënësi gjatë jetës së tij bashkëshortore nuk ka pasur fëmijë përfshirë ata natyrorë dhe të adoptuar, atëherë pasuria trashëgimore trashëgohet nga bashkëshortja/i dhe prindërit e trashëgimlënësit.<sup>103</sup>

Sipas Ligjit për trashëgimi neni 16 *“masën trashëgimore të të vdekurit i cili nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit dhe bashkëshortja/i i/e tij/saj. Prindërit e të vdekurit e trashëgojnë gjysmën e masës trashëgimore në pjesë të barabarta, ndërsa gjysma tjetër e trashëgon bashkëshorti/ja i/e të vdekurit.”*<sup>104</sup>

P.sh. nëse trashëgimlënësi pas vete ka lënë bashkëshorten dhe prindërit e tij, kurse pasuria trashëgimore vlersohet në shumë 120.000 euro atëherë pasuria trashëgimore në vlerë 60.000 euro ose  $\frac{1}{2}$  do ti takonte bashkëshortes së trashëgimlënësit, kurse gjysma tjetër në vlerë prej prej 60.000 euro do të ndahet në dy pjesë të barabarta në mes prindërve të trashëgimlënësit d.m.th  $2 \times 30.000$  euro ose  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore.<sup>105</sup>




Fig.5

Përveç personave të theksuar, me të drejtën e përfaqësimit në rendin e dytë të trashëgimisë mund të thiren vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre në vend të njërit apo të dy prindërve.<sup>106</sup>

<sup>103</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, *“E drejta trashëgimore”*, Prishtinë, 2007, fq.63.

<sup>104</sup> Neni 16, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>105</sup> Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, *“E drejta trashëgimore”*, Prishtinë, 2007,, fq.63.

<sup>106</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследно право”*, Скопје, 2016, fq.137.

Në këtë rend hyjnë edhe i ushqyeri, ushqyesi, thjeshtri dhe thjeshtra, njerku dhe njerka, reja dhe vjehri dhe vjehra, dhëndri dhe gjyshi dhe gjyshja dhe persona që janë në gjini të gjakut, që kanë jetuar në bashkësi të vazhdueshme, reciprokisht trashëgohen me kusht që i vdekuri mos ketë lënë bashkëshort dhe trashëgimtar të tjerë të rendit të parë dhe prindër dhe vëllezër dhe motra. Në këtë rast këto persona e trashëgojnë tërë masën trashëgimore në pjesë të barabarta.<sup>107</sup>

Pozita juridiko trashëgimore e bashkëshortit në këtë rend është specifike pasi që për dallim nga trashëgimtarët e tjerë, bashkëshorti mund të paraqitet si trashëgimtar ose në rendin e parë ose në rendin e dytë të trashëgimisë varësisht prej personave me të cilët konkuron.<sup>108</sup> Përderisa trashëgimlënësi ka lënë pasardhës, bashkëshorti konkuron në rendin e parë kurse nëse nuk ka pasardhës bashkëshorti do të konkurojë me prindërit në rendin e dytë të trashëgimisë.

Përveq kësaj në rendin e dytë si trashëgimtar mund të paraqitet vetëm bashkëshorti ose vetëm prindërit.<sup>109</sup>

- ❖ Nëse i vdekuri *nuk ka lënë bashkëshort*, prindërit e të vdekurit e trashëgojnë tërë masën trashëgimore në pjesë të barabarta.<sup>110</sup>
- ❖ Nëse *njëri prind i trashëgimlënësit ka vdekur* para trashëgimlënësit, pjesën e masës trashëgimore që do ti kishte takuar po të kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat dhe stërnipat e tij dhe pasardhësit e tyre të mëtutjeshëm, sipas rregullave që vlejné për rastin kur të vdekurin e trashëgojnë fëmijët e tij dhe pasardhësit tjerë.
- ❖ Nëse *të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur* para trashëgimlënësit pjesën e masës trashëgimore që do i kishte takuar secilit prej tyre po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë pasardhësit tjerë.

Në të gjitha rastet vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit nga ana e babait e trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e trashëgimisë të babait, vëllezërit dhe motrat nga ana e nënës e trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e nënës.<sup>111</sup>

---

<sup>107</sup> Neni 299, paragrafi 1, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>108</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, *"Наследно Право"*, Штип, 2009, fq.115.

<sup>109</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *"Наследно право"*, Скопје, 2016, fq.137.

<sup>110</sup> Neni 16, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.



P.sh. nëse trashëgimlënësi pas vete ka lënë bashkëshorten dhe njërin prind (babain) kurse nëna nuk e ka mbijetuar trashëgimlënësin, në këtë rast gjysmën e masës trashëgimore  $\frac{1}{2}$  e trashëgon bashkëshortja kurse gjysmën tjetër babai ( $\frac{1}{4}$ ) dhe pasardhësit e të ëmës në këtë rast vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënëit (nga  $\frac{1}{8}$ ).




Fig.6.

Sipas nenit 19 të ligjit për trashëgimi “nëse të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë masën trashëgimore e trashëgon bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit.”<sup>112</sup>

Në lidhje me pyetjen kur pozita e bashkëshortit është më e favorshme në rendin e parë ose në rendin e dytë të trashëgimisë, në parim, pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortit është më e favorshme në rendin e dytë të trashëgimisë pasi që me ligj është caktuar pjesë trashëgimore që përfshin gjysmën e trashëgimisë.

Megjithatë bashkëshorti mund të paraqitet edhe si trashëgimtar i vetëm në rendin e parë në rastet kur të gjithë trashëgimtarët e rendit të parë kanë hequr dorë nga trashëgimia.<sup>113</sup> Poashtu edhe në rendin e dytë të trashëgimisë bashkëshorti mund të paraqitet si trashëgimtar i vetëm, kjo ndosh atëherë kur nuk ka trashëgimtar në rendin e dytë ose janë të padenjë për të trashëguar ose kanë hequr dorë nga trashëgimia.<sup>114</sup>

<sup>111</sup> Neni 17, Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>112</sup> Neni 19, po aty, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>113</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, “Наследно Право”, Штип, 2009, fq.116.

<sup>114</sup> Чавдар Кирил, “Коментар на Законот за наследувањето” Агенција академик, Скопје, 1996, fq.46.

#### 4.2.1. Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në rendin e dytë të trashëgimisë


Në rendin e dytë të trashëgimit madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit është e ndryshme, varësisht nga rrethi i bashktrashëgimtarëve të cilët bashkë me të konkurojnë në trashëgimi.

Prej këtu mund të konkludojmë se, madhësia e pjesës së bashkëshortit nuk është paraprakisht e caktuar dhe çdo here varret nga rrethi i bashkë-trashëgimtarëve, statusit të tyre pasuror poashtu edhe madhësia e trashëgimisë.<sup>115</sup>

Bashkëshorti në rendin e dytë të trashëgimisë konkuron bashkë me prindërit e trashëgimlënësit. Madhësia e pjesës trashëgimore të bashkëshortit dhe të prindërve është e barabartë, respektivisht bashkëshorti trashëgon një të trashëgimisë (gjysmën) dhe prindërit gjysmën tjetër të trashëgimisë në pjesë të barabarta.

Sipas Ligjit për trashëgimi neni 16 paragrafi 2 *“Prindërit e të vdekurit e trashëgojnë gjysmën e masës trashëgimore në pjesë të barabarta, ndërsa gjysmën tjetër e trashëgon bashkëshorti i të vdekurit”*.

Nëse i vdekuri nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e të vdekurit e trashëgojnë tërë masën trashëgimore në pjesë të barabarta.<sup>116</sup>



Nëse të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë asnjë pasardhës, tërë masën trashëgimore e trashëgon bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit.<sup>117</sup>

<sup>115</sup> Хаџи Василев Вардарски Миле, *“Наследно Право”*, Скопје, 1983, fq.130.

<sup>116</sup> Neni 16, paragrafi 3, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

Nëse njëri prind i trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, ndërsa nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e masës trashëgimore që do ti kishte takuar po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgon prindi tjetër, dhe nëse edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e trashëgojnë atë që do ti kishte takuar edhe prindit tjetër.<sup>118</sup> Në këtë rast bashkëshorti konkuron me vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit. Edhe në këtë rast, pjesa trashëgimore e bashkëshortit mbetet e pandryshuar d.m.th. e trashëgon gjysmën e masës trashëgimore kurse gjysmën tjetër e trashëgojnë vëllezërit dhe motrat pjesën e prindërve të tyre.

Bashkëshorti në rendin e dytë të trashëgimisë mund të konkurojë edhe me persona të tjerë që jetojnë në një bashkësi të përbashkët me trashëgimlënësin. Për këtë duhet të përmbushen disa kushte:

- a) Të mos egzistojë trashëgimtarë në rendin e parë të trashëgimisë
- b) Të egzistojë bashkësi e përhershme mes këtyre personave
- c) Bashkësia e përhershme të egzistojë mes personave të numëruar taksativisht me ligj.
- d) Kohëzgjatja e bashkësisë duhet të jetë specifike sëpaku 5 vite pandërprerë që prej fillimit të kësaj bashkësie e deri në vdekjen e trashëgimlënësit.

Nëse trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtar në rendin e parë dhe prindër dhe vëllezër dhe motra atëherë personat që jetojnë në bashkësinë e vazhdueshme nuk mund të jenë trashëgimtar.<sup>119</sup>

Kur në trashëgimi është thirrur bashkëshorti, personat që jetojnë në një bashkësi të vazhdueshme trashëgojnë në pjesë të barabarta njëren gjysmë nga pjesa e masës trashëgimore që do ta kishin trashëguar prindërit përkatësisht vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit.<sup>120</sup>

---

<sup>117</sup> Neni 19, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>118</sup> Neni 18, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>119</sup> Чавдар Кирил, "Коментар на Законот за наследувањето" Агенција академик, Скопје, 1996, fq.66.

<sup>120</sup> Neni 29 paragrafi 1, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

Me shprehjen “bashkësinë e vazhdueshme” kuptojmë atë bashkësi e cila ka zgjatur së paku 5 vite dhe atë pa ndalur që nga themelimi i mardhënjeve e deri në vdekje.<sup>121</sup>

Me këtë mund të konkludojmë se bashkëshorti edhe pse konkuron me trashëgimtarë të tjerë në rendin e dytë pjesa trashëgimore e tij/saj nuk zvogëohet por ndahet në pjesë të barabarta sipas të cilës gjysma e pjesës trashëgimore i takon bashkëshortit.

#### **4.2.2. Rritja e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në rendin e dytë të trashëgimisë**

Kur bashkëshorti i cili nuk ka mjete për jetesë është thirrur në trashëgimi me trashëgimtarët e rendit të dytë të trashëgimisë, gjykata mundet me kërkesë të bashkëshortit, të vendosë që bashkëshorti të trashëgojë edhe një pjesë nga pjesa e masës trashëgimore, ndërsa mund të vendosë që bashkëshorti të trashëgojë tërë masën trashëgimore.

Gjatë vendosjes gjyqi do të merr parasysh të gjithë rrethanat e rastit e veçanërisht rrethanat pasurore dhe aftësisë për ekonomizim të bashkëshortit, rrethanat pasurore të trashëgimtarëve të tjerë dhe aftësisë së tyre për ekonomizim dhe vlerën e masës trashëgimore.<sup>122</sup> Për rritjen e pjesës trashëgimore të bashkëshortit gjykata do të vendos vetëm nëse bashkëshorti ka paraqitur kërkesë.

Kërkesën për rritjen e pjesës trashëgimore të bashkëshortit, bashkëshorti mund ta paraqet nën kushte të caktuara:

- a) Të jenë thirrur në rendin e dytë të trashëgimisë (me prindërit e trashëgimtarëve të tjerë),
- b) Të mos ketë kushte të domosdoshme për jetesë,
- c) Vlera e masës trashëgimore të jetë e vogël,
- d) Statusi i pronësisë së paraqitësit të kërkesës duhet ti referohet kërkesës,
- e) Statusi pronësor i trashëgimtarëve të tjerë të jetë e mundshme për arsyetimin e kërkesës.<sup>123</sup>

---

<sup>121</sup> Neni 29 paragrafi 3, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>122</sup> Neni 27, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>123</sup> Чавдар Кирил, “Коментар на Законот за наследувањето” Агенција академик, Скопје, 1996, fq.61.

Gjykata duhet t'i merr pasarysh të gjithë rrethanat në rastin konkret. Në bazë të të dhënave gjyqi do të vendos se a do të rrisë masën trashëgimore dhe në barrën e cilit trashëgimtar (të bashkëshortit, prindërve apo pasardhësve të tyre).

Deri në rritjen e masës trashëgimore të bashkëshortit mund të vijë vetëm në rastet kur konkuron me trashëgimtarët në rendin e dytë. Për realizimin e kësaj kërkesë është e nevojshme të përmbushet kushti më i rëndësishëm që është mospasja e kushteve të domosdoshme për jetesë.

Gjykata do të konstatojë se bashkëshorti a ka aftësi për punë, a ka kushte të domosdoshme për jetesë, të ardhurat e tij/saj, në momentin e vdekjes së trashëgimtarit por edhe më vonë a do të ketë aftësi për punë, për përmbushjen e kushteve për jetesë. Pas saj do të mirren pasarysh të gjithë burimet e të ardhurave të bashkëshortit e jo vetëm të ardhurat që vijnë nga pasuria trashëgimore, këtu hyjnë sendet e përbashkëta. Të gjithë këto janë rrethana të rëndësishme në bazë të së cilës konstatohet se bashkëshorti a ka apo nuk ka kushte për jetesë.<sup>124</sup>

Mosegzistimi i kushteve për jetesë të bashkëshortit llogaritet si kushti i domosdoshëm nga i cili varet rritja e pjesës trashëgimore të bashkëshortit, e në disa raste edhe fitimi i tërë pasurisë trashëgimore. Egzistimi i këtij kushti domosdo duhet të vërtetohet.

Në qoftë se mes bashkëshortëve dhe trashëgimtarëve të tjerë egzistojnë kundërthënje për faktet, gjykata do ta ndërpresë procedurën për ndarjen e trashëgimisë dhe do ta udhëzojë palën në proces, e drejta e të cilit është më pak e besueshme, për shkak se bëhet fjalë për faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore.<sup>125</sup> Në qoftë se mes trashëgimtarëve nuk ka kundërthënje për faktet, kurse kundërthënje egziston për pranimin e të drejtës, për këto kundërthënje do të vendos gjykata.<sup>126</sup> Gjykata do të kujdeset që të mos dëmtohen interesat e trashëgimtarëve të tjerë.

---

<sup>124</sup> Благојевиќ Т. Борислав, Антиќ Б. Оливер, "Наследно Право", Београд, 1991, fq.172.

<sup>125</sup> Neni 173, paragrafi 1 dhe 2, pika 3, *ligji për procedurë jashtkontestimore*, dhe neni 176, *ligji për procedurë jashtkontestimore*, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/79.

<sup>126</sup> Neni 173, paragrafi 3, *ligji për procedurë jashtkontestimore*, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/79.

Në praktikën gjyqësore paraqiten shumë raste të ndryshme që kanë të bëjnë me rritjen e pjesës trashëgimore të bashkëshortit p.sh.

-Në pajtim me nenin 27 të ligjit për trashëgimi, kur bashkëshorti i cili nuk ka kushte të domosdoshme për jetesë është thirur në trashëgimi në rendin e dytë bashkë me vëllezërit e trashëgimlënësit( me të drejtë të përfaqësimit), në bazë të kërkesës së bashkëshortit, gjykata do të vendosë, njëren pjesë të trashëgimisë që sipas ligjit i takon trashëgimtarëve të tjerë, ti takojë bashkëshortit.<sup>127</sup>

-Gjykata mund të vendos që gjithë masën trashëgimore të trashëgojë bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit, e cila/i cili është thirë në trashëgimi me trashëgimtarët e rendit të dytë, në qoftë se masa trashëgimore është e një vlere aq të vogël saqë me ndarjen e saj bashkëshorti do të bie në vobegësi.<sup>128</sup>

Përderisa përmbushen të gjithë kushtet për rritjen e pjesës trashëgimore të bashkëshortit, gjykata do të vendos se nën ngarkesën e cilit nga trashëgimtarët dhe në çfarë forme do të realizojë rritjen e pjesës trashëgimore.

Pjesa trashëgimore e bashkëshortit në rendin e dytë të trashëgimisë, përveç se mund të zmadhohet, mund edhe të zvogëlohet në favor të prindërve të trashëgimlënësit.

Kur prindërit të cilët nuk kanë mjete të nevojshme për jetesë janë thirrur në trashëgimi me bashkëshortin e trashëgimlënësit, gjykata mundet, sipas kërkesës së tyre, të vendos të trashëgojë edhe një pjesë nga ajo pjesë e masës trashëgimore që sipas ligjit duhet të trashëgohet nga bashkëshorti, ndërsa mund të vendos që prindërit ta trashëgojnë tërë masën trashëgimore, nëse ajo është e një vlere aq të vogël saqë me ndarjen e saj prindërit do të kishin rënë në vobegësi.<sup>129</sup>

Nëse në mes të prindërve të trashëgimlënësit bashkësia e jetesës është ndërprerë për një kohë të gjatë, ndërsa vetë njëri prind nuk ka mjete të domosdoshme për jetesë, ai mund të kërkojë t'i rritet pjesa trashëgimore si ndaj bashkëshortit ashtu edhe ndaj prindit tjetër të trashëgimlënësit.

---

<sup>127</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, nr.156/63, 09.01.1964.

<sup>128</sup> Vendimi i Gjykatës Supreme, nr.256/58.

<sup>129</sup> Neni 28, *Ligjit për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

Gjatë vendosjes gjykata do t'i merr parasysh të gjithë rrethanat e rastit, e veçanërisht rrethanat pasurore dhe aftësisë për ekonomizim të prindërve, rrethanat pasurore të bashkëshortit përkatësisht të trashëgimtarëve të prindit të vdekur dhe aftësia e tyre për ekonomizim dhe vlerën e masës trashëgimore.<sup>130</sup>

Duke analizuar nenin 28 të ligjit për trashëgimi mund të vërejmë se është parashikuar mundësia e rritjes së pjesës trashëgimore të prindërve, në këtë rast pasi që prindërit në rendin e dytë të trashëgimisë konkurojnë me bashkëshortin/ten kjo rritje e pjesës së tyre bëhet në ngarkesë të bashkëshortit, dmth zvogëlohet pjesa trashëgimore e bashkëshortit por gjithmonë gjykata i merr parasysh të gjithë rrethanat pasurore dhe veçanërisht shikon që mos dëmtohet pala e cila i zvogëlohet pjesa trashëgimore.

---

<sup>130</sup>Neni 28, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

### 4.3. Humbja e së drejtës trashëgimore të bashkëshortit

Bashkëshorti paraqitet si trashëgimtar në rendin e parë dhe në rendin e dytë. Në rendin e parë kur konkuron me pasardhësit e trashëgimlënësit (fëmijët e tij/saj) dhe në rendin e dytë ku bashkëshorti konkuron me prindërit e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre (vëllezërit dhe motrat).

Bashkëshorti që të jetë trashëgimtar duhet të përmbushen disa kushte të cilat nëse nuk përmbushen bashkëshorti humb të drejtën në trashëgimi. Si kusht themelor që bashkëshorti të jetë trashëgimtar është që në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit të jetë në bashkësi të vlefshme martesore me trashëgimlënësin.

Në nenin 26 të ligjit për trashëgimi është parashikuar se në cilat raste bashkëshorti e humb të drejtën në trashëgimi. E drejta në trashëgimi në mes të bashkëshortëve ndërpritet me shkurorëzim të martesës dhe me anulim të martesës.

Bashkëshorti nuk ka të drejtë në trashëgimi nëse:

- 1) trashëgimlënësi ka parashtruar padi për shkurorëzim të martesës, ndërsa pas vdekjes së trashëgimlënësit është zgjidhur martesa me shkurorëzim me aktgjykim të formës së prerë, ose nëse bashkëshorti dhe trashëgimlënësi kanë parashtruar propozim për shkurorëzim me marrëveshje, ndërsa deri në vdekjen e trashëgimlënësit procedura e atij propozimi nuk është mbaruar;
- 2) martesa e tij me trashëgimlënësin anulohet me aktgjykim të formës së prerë pas vdekjes së trashëgimlënësit, për shkaqe për të cilën bashkëshorti pasjetues ka ditur në kohën e lidhjes së martesës;
- 3) bashkësia e tij e jetesës me trashëgimlënësin ka mbaruar vazhdimisht me fajin e tij ose me marrëveshje me trashëgimlënësin.

Me shkurorëzim dhe anulim të martesës bashkëshorti e humb të drejtën t'i kërkojë interes për të, të parashikuar me testament ose në ndonjë disponim tjetër në rast vdekjeje, të bërr para shkurorëzimit përkatësisht anulimit të martesës me bashkëshortin e tij të mëparshëm.<sup>131</sup>

---

<sup>131</sup> Neni 26, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.



- E drejta për trashëgimi të bashkëshortit ndërpritet me shkurorëzim të martesës

Martesa mund të shkurorëzohet me marrëveshje të ndërsjelltë të bashkëshortëve por, edhe me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve në qoftë se marrëdhëniet bashkëshortore janë ç'rregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, në qoftë se bashkësia martesore faktikisht ka pushuar së egzistuari më tepër se një vit.<sup>132</sup>

- Martesa pushon edhe me anulimin e martesës.

Martesa do të anulohet nëse vërtetohet se gjatë lidhjes së martesës ka egzistuar ndonjë pengesë<sup>133</sup> (martesa nën moshën 18 vjet, në rastet kur martesa e mëparshme nuk i ka pushuar, martesa e lidhur me personat që kanë sëmundje psiqike me simptome psihotike, me të meta mendore IQ nën 36 shkallë, personat që kanë sëmundje trashëgimore, në rastet kur pajtimi për lidhjen e martesës është dhënë nën dhunë apo lajthim, nuk mund të lidhun martesë të afërimit e gjinisë së gjakut, gjinia e krushqisë, gjinia e adoptimit, poashtu edhe gjinia jashtmartesore paraqet pengesë si edhe gjinia martesore).<sup>134</sup>

Në pajtim me nenin 230 të ligjit për familje: e drejta në padi për anulimin dhe shkurorëzimin të martesës, nuk kalon tek trashëgimtarët. Trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur, i cili e ka paraqitur këtë padi mund të kërkojnë të vërtetohet se padia për anulim, respektivisht për shkurorëzim ka qenë e bazuar.

Kërkesa nga padia për anulim dhe shkurorëzim mund të theksohet në procesin e filluar nga bashkëshorti i vdekur, nëse nga vdekja e tij nuk ka kaluar më tepër se gjashtë muaj. Pas kalimit të këtij afati procedura ndërpritet.<sup>135</sup> Kurse, në rastet kur është paraqitur padi për shkurorëzim me marrëveshje atëherë bashkëshorti pasjetues e humb të drejtën për trashëgimi të trashëgimisë së bashkëshortit të vdekur, i cili ka vdekur gjatë procedurës për shkurorëzim me marrëveshje ose pas shkurorëzimit me marrëveshje. Në këtë situatë

---

<sup>132</sup> Neni 39, 40, 41, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.80/92.*

<sup>133</sup> Neni 35, *po aty, gazeta zyrtare nr.80/92.*

<sup>134</sup> Nenet 17 - 22 , *po aty, gazeta zyrtare nr.80/92.*

<sup>135</sup> Neni 230, *po aty, gazeta zyrtare nr.80/92.*

pasardhësit e trashëgimlënësit nuk kanë nevojë që të vazhdojnë procedurën për shkuorëzim me marrëveshje.<sup>136</sup>

- Bashkëjsia e jetesës me trashëgimlënësin mund të mbarojë përgjithmonë me fajin e vet ose me marrëveshje me trashëgimlënësin.

Bashkëjetesa mund të mbarojë me dëshirën e të dy bashkëshortëve në atë mënyrë që vendosin që të mos jetojnë më së bashku dhe këtë kërkesë të tyre ta realizojnë. Kjo ndarje mund të ndodh edhe atëherë kur jetojnë në një shtëpi apo banesë por e kanë ndarë haspirën banesore.

Mbarimi i bashkëjetesës duhet të jetë i vazhdueshëm, përgjithmonë dhe të mos kryhen funksionet familjare siç janë: ndihmë e përbashkët, marrëdhënjet seksuale, strehim të përbashkët etj.

Në qoftë se faji për mbarimin e bashkëjetesës është tek trashëgimlënësi, bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të trashëgojë masë trashëgimore por me kusht që të mos jetë pajtuar me ndarjen e kësaj bashkësie apo të mos ketë bashkëjetuar me ndonjë tjetër. Megjithatë në qoftë se me fajin e bashkëshortit pasjetues ka mbaruar bashkësia atëherë ai/ajo humb të drejtën e trashëgimisë. Poashtu bashkëshorti pasjetues humb të drejtën e trashëgimisë edhe kur bashkësia ka mbaruar me marrëveshje të ndërsjelltë.<sup>137</sup>

Gjykata gjatë konstatimit do t'i merr parasysh të gjithë rrethanat, veçanërisht dijeninë e bashkëshortëve se kanë jetuar në bashkësi të përbashkët, kohëzgjatjen etj.

Bashkëshorti humb të drejtën e trashëgimisë edhe me testament në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë testament para shkurorëzimit apo anulimit të matesës.

Në të gjithë këto raste bashkëshorti humb të drejtën në trashëgimi që do të thotë se nuk mund të paraqitet si trashëgimtar.

---

<sup>136</sup>Чавдар Кирил, "Коментар на Законот за наследувањето" Агенција академик, Скопје, 1996, fq.55.

<sup>137</sup> По ату, fq.57.

## 5. Të drejtat e tjera që i përkasin bashkëshortit

Përveç të drejtave pasurore trashëgimore, egzistojnë edhe të drejta të tjera që nuk hyjnë në kuadër të pasurisë trashëgimore.

Këtu hyjnë të drejtat personale (të drejtat e emrit, respektit, besnikërisë etj.) pastaj pjesë e pasurisë së përbashkët të bashkëshortit e cila ndahet nga pronësia trashëgimore, si dhe sendet nga amvisëria.

### 5.1. Pasuria e përbashkët e bashkëshortit

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është e rregulluar me ligjin për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore.

Pronësi e përbashkët është pronësi e disa personave mbi një send të pandarë kur pjesët e tyre janë të përcaktueshme, por nuk janë të përcaktuar paraprakisht.

Pronësi e përbashkët egziston në rastin e fitimit të pronësisë në bashkësinë martesore, bashkësinë jashtmartesore, në rast të fitimit të pasurisë në bashkësinë trashëgimore, në bashkësinë familjare dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Kur sendi është në pronësi të përbashkët në këtë nuk ka rëndësi fakti se në librin publik ai është regjistruar si pronësi e vetëm njërit prej tyre, por kjo nuk do të ndikojnë në të drejtën e palëve të treta të cilët nuk e kanë ditur dhe nuk kanë qenë të detyruar ta dijnë.<sup>138</sup>

Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë e përashkët dhe e ndarë. Pasuria të cilët bashkëshortët e fitojnë gjatë kohëzgjatjes së martesës paraqet pronësi të tyre të përbashkët kurse pasuria, të cilët njëri prej bashkëshortëve e ka pasur në kohën e lidhjes së martesës paraqet pasuri e tij të veçantë, (pasuria që e ka sjell në bazë të trashëgimit, legut, dhuratës, sendet për kënaqjen e kërkesave personale).<sup>139</sup>

E drejta e pronësisë së bashkëshortëve mbi paluajtshmëritë, të cilët janë pronësi e përbashkët e tyre regjistrohet në libra publik në emër të të dy bashkëshortëve si pronësi e përbashkët e tyre. Edhe në rastet kur në libra publik si pronar është regjistruar njëri prej tyre llogaritet se regjistrimi është kryer në emër të të dy bashkëshortëve. Nëse në libra

<sup>138</sup> Neni 59, *Ligjit për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.18/01.

<sup>139</sup> Neni 66, 67 dhe 68, po aty.

publik janë regjistruar të dy bashkëshortët si bashkëpronar të pjesëve të caktuara do të llogaritet se në atë mënyrë i kanë vërtetuar pjesët në pasurinë e përbashkët.<sup>140</sup>

Bashkëshortët bashkarisht dhe me marrëveshje administrojnë dhe disponojnë me pasurinë e përbashkët. Me pjesën e vet në pasurinë e përbashkët para se ajo të përcaktohet, bashkëshorti nuk mund të administrojë në mënyrë të pavarur dhe as të ngarkojë me anë të punëve juridike në mes të gjallëve.<sup>141</sup>

Gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe pas pushimit të saj bashkëshortët me marrëveshje mund të ndajnë pasurinë e përbashkët. Me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve krijohet regjimi i pasurisë së veçantë.<sup>142</sup>

Pasuria të cilët bashkëshortët jashtëmartesorë do ta fitojnë në bashkësinë jashtëmartesore konsiderohet si pasuri e përbashkët e tyre.

Sa i përket administrimit dhe disponimit, përcaktimit të pjesës në pasurinë e fituar në bashkësinë jashtëmartesore dhe gjatë ndarjes së pasurisë në bashkësinë jashtëmartesore në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore mbi pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve martesorë.<sup>143</sup>

---

<sup>140</sup> Neni 69, *Ligjit për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr. 18/01.

<sup>141</sup> Neni 70, paragrafi 1 dhe 2, po aty.

<sup>142</sup> Neni 74, po aty.

<sup>143</sup> Neni 81, po aty.

## 5.2. Sendet e amvisërisë

Brenda rendit të parë për trashëgimi, ligdhënësi paraqet rregulla të veqanta për trashëgiminë, të cilët kanë të bëjnë kryesisht me sendet e amvisërisë që në momentin e vdekjes i përkasin trashëgimlënësit. Me sendet shtëpiake që shërbejnë për kënaqjen e kërkesave të përditshme kuptojmë mobiljet, mbulesat, sendet dhe pajisjet në kuzhinë, teknika e bardhë, televizori, sistemi për muzikë në përgjithësi pajisjet për hapsirë jetësore, në të cilën nuk hyjnë sendet që kanë vlerë të madhe siç janë p.sh. pikturat, skulpturat, zbukurimet me vlerë etj. Këto sende ndahen nga trashëgimi, kështu që nuk llogariten në masën trashëgimore të trashëgimlënësit e as në pjesën e domosdoshme.

Ndarja e sendeve të amvisërisë nga trashëgimia ka egzistuar në ligjin për trashëgimi të vitit 1973.<sup>144</sup> Poashtu ka qenë e rregulluar edhe me ligjin për trashëgimi të vitit 1955 në nenin 38.<sup>145</sup> Për dallim nga këto ligje në ligjin e ri për trashëgiminë të vitit 1996, personat të cilët kanë të drejtë për ndarjen e sendeve të amvisërisë janë taksativisht të numëruar në këtë ligj. Kështu në ligj thuhet se: bashkëshortit, paraardhësve, adoptuesit, pasardhësve, të adoptuarit dhe pasardhësve të tij dhe personave të tjerë nga neni 29 i ligjit për trashëgimi (i ushqyeri dhe ushqyesi, thjeshtri dhe thjeshtra, njerku dhe njerka, reja dhe vjehri dhe vjehra, dhëndri dhe gjyshi dhe gjyshja dhe personat që janë në gjini gjaku) të cilët kanë jetuar me trashëgimlënësin në të njëjtin amvisëri u takojnë sendet e amvisërisë që shërbejnë për kënaqjen e nevojave të tyre të përditshme, përveç sendeve me vlerë më të konsiderueshme.<sup>146</sup>

Në praktikë shfrytëzues i kësaj të drejte në të shumtën e rasteve janë: bashkëshorti/ja, fëmijët dhe pasardhësit e tyre pasi që këto janë personat që zakonisht jetojnë në një amvisëri të përbashkët. Me këtë institut u mundësohet personave që jetojnë në një amvisëri të përbashkët ti shfrytëzojnë sendet që shërbejnë për kënaqjen e nevojave të tyre të përditshme. Shfrytëzimi i këtyre sendeve vazhdon të jetë e njëjtë si edhe para vdekjes së trashëgimlënësit.<sup>147</sup>

---

<sup>144</sup> Neni 36, *Ligji për trashëgimi*, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative Jugosllave, nr.35/1973.

<sup>145</sup> Neni 38, *Ligji për trashëgimi*, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative Jugosllave, nr.2/1955.

<sup>146</sup> Neni 37, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>147</sup> Благојевиќ Т. Борислав, "Наследно право у Југославију", права република и покрајина, савременена администрација, 1983.

### 5.3. Sendet për përdorim personal

Në ligjin për pronësi dhe të drejtat tjera sendore egzistojnë të drejta që shërbejnë për rregullimin e statusit të drejtave personale të cilët i takojnë bashkëshortit.

Kështu në nenin 76 të ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët me kërkesë të bashkëshortit, në pjesën e tij në rend të parë do të hyjnë ato sende nga pasuria e përbashkët, të cilët shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së tij, poashtu do të ndahen edhe sende të fituara me punë gjatë bashkësisë martesore, të cilët shërbejnë për përdorim personal të tij.<sup>148</sup>

---

<sup>148</sup> Neni 76 Ligjit për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr. 18/01.

## KAPITULLI IV

### 6. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve jashtmartesorë

Martesa ka pasur një trajtim të veçantë jo vetëm në vendet tona por edhe në vendet tjera Evropiane, me kalimin e kohës kjo pozitë monopoliste e martesës gradualisht filloi të zbehet. Ky transformim mund të vërehet nëpërmjet rregullave që rregullojnë këto të drejta siç është liberalizimi i të drejtave për shkurorëzim dhe gradualisht nxjerrja e rregullave për bashkësinë jashtmartesore. Si rezultat nga kjo vërehet se në të drejtën bashkëkohore martesa nuk është më bashkësi e vetme për formimin e familjes. Në këtë drejtim gjithnjë është më i madh numri i vendeve Evropiane, të cilët në sistemin e tyre të së drejtës i mundësojnë partnerëve të vendosin se a do të lidhin martesë apo do të jetojnë në një formë tjetër të bashkësisë të rregulluar me ligj.<sup>149</sup>

Ndryshimet e këtilla në periudhën moderne kanë ndikim të madh në të drejtën trashëgimore, kryesisht për pozitën juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve jashtmartesorë privilegjet e të cilëve më parë kishin vetëm bashkëshortët martesorë.<sup>150</sup>

Në të kaluarën pothuajse ishte e padiskutueshme se me termin bashkësi jashtmartesore kuptojmë bashkësinë e vazhdueshme të një burri dhe gruaje, përkatësisht të personave me gjini të ndyrshme. Ky supozim egziston edhe në ditët e sotme, në vendet ku e drejta e tyre ende nuk e rregullon bashkësinë mes personave me gjini të njëjtë.<sup>151</sup>

Rëndësia e bashkësisë jashtëmartesore është e madhe në të drejtën bashkëkohore, duke pasur parasysh se ajo paraqet bazë për formimin e familjeve jashtëmartesore. Bashkësia jashtëmartesore një kohë të gjatë ka qenë e anashkaluar, pasojat e të cilëve i kanë përjetuar fëmijët jashtëmartesorë, të cilët kanë qenë të diskuriminuar në krahasim me fëmijët martesorë.

---

<sup>149</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Реформата на наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2016, fq.28-29.

<sup>150</sup> По ату, fq.28-29.

<sup>151</sup> По ату, fq.29.

Në vitin 1970 shteti Suedez, aprovoi njohjen e pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve jashtëmartesorë. Me këtë ndryshim për herë të parë në Europë pozita e bashkëshortit jashtëmartesor është e barabartë me pozitën e bashkëshortit martesorë.<sup>152</sup>

Ndryshimet që u bënë në Suedi ndikuan që edhe në vendet tjera të pranohen këto rregulla si në vendet: Sllovenija (1976), Kroacia (2003), Kosova (2004), Mali i Zi (2008).

Duke pasur parasysh atë se bashkësia jashtëmartesore gjithmonë na paraqitet si forma më e shpeshtë dhe më e pranuar e bashjetesës, si dhe rritja e numrit të fëmijëve jashtëmartesor, na paraqitet nevoja që kjo e drejtë të shqyrtohet edhe në të drejtën e Republikës së Maqedonisë.<sup>153</sup>

---

<sup>152</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Реформата на наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2016, fq.29.

<sup>153</sup> По ату, fq.30.



## 6.1. Nocioni i bashkësisë jashtëmartesore

Në të drejtën bashkëkohore martesë nuk është forma e vetme për formimin e familjes dhe për realizimin e marrëdhënjeve familjare. Ndryshimet bashkëkohore në familje dhe në të drejtën familjare kanë ndikim të madh edhe në të drejtën trashëgimore. Për të kuptuar statusin e bashkëshortëve jashtëmartesorë në të drejtën trashëgimore është e nevojshme të bëhet analizim i të drejtës trashëgimore në Republikën e Maqedonisë, por, edhe në vendet tjera.<sup>154</sup>

Bashkësia jashtëmartesore paraqet bashkësi jetese të vazhdueshme e një burri dhe gruaje të cilët nuk kanë lidhur martesë të plotfuqishme. Për dallim nga martesë, bashkësia jashtëmartesore paraqet bashkësi joformale e cila lidhet me dëshirën e plotë dhe të lirë të bashkëshortëve me qëllim që të jetojnë dhe të kryejnë funksione familjare. Bashkësia jashtëmartesore, ashtu si që lidhet në mënyrë joformale ashtu edhe pushon me dëshirën e dyanshme të partnerëve apo me vullnetin e njërës palë.

Mënyra e themelimit të bashkësisë jashtëmartesore dallohet thelbësisht nga mënyra e themelimit të martesës. Ky dallim veçanërisht është i shprehur në pikëpamje të kushteve formale, e më pak në pikëpamje të kushteve materiale. Martesë themelohet me vullnetin e palëve, që duhet të deklarohen në formën e parashikuar me ligj. Ndërsa, bashkësia jashtëmartesore themelohet me vullnetin e lirë të palëve, pra në mënyrë joformale ose në mënyrë konkludente, do me thënë me themelimin e bashkësisë së jetesës në mënyrë faktike. Për të qenë e plotfuqishme bashkësia jashtëmartesore, duhet të plotësohen këto kushte: egzistimi i jetës së përbashkët, jeta e përbashkët të vazhdojë një kohë të gjatë dhe të mos ketë pengesa martesë.<sup>155</sup>

Subjekte të bashkësisë jashtëmartesore janë personat fizik me zotësi juridike dhe me zotësi veprimi.

Llojet e bashkësisë jashtëmartesore janë:

- **e çastit** – përfshin marrëdhënjet intime momentale midis burrit dhe gruas

---

<sup>154</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Реформата на наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2016, fq.76.

<sup>155</sup> <https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>, (06.02.2018).

- **e përkohshme** – përfshin marrëdhënjet intime momentale të burrit dhe gruas, por që zgjat një kohë të caktuar dhe
- **e vazhdueshme** – përfshin jetën e përbashkët të vazhdueshme midis burrit dhe gruas që i ngjan martesës.<sup>156</sup>

Ndërmjet bashkësisë martesore dhe jashtëmartesore egzistojnë ngjajshmëri dhe dallime, ngjajshmëritë midis këtyre dy institucioneve qëndron në faktin se si njëri si tjetri janë bashkësi jetese e vazhdueshme, kurse dallimi është se bashkësia jashtëmartesore themelohet në mënyrë faktike, pra me vullnet të lirë të dyanshëm, joformale kurse martesa themelohet në mënyrë formale-juridike, me kontratë në formë solemne. Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi jetese faktike, kryesisht e parregulluar me ligj, kurse martesa është bashkësi jetese e rregulluar me ligj. Bashkësia jashtëmartesore pushon në mënyrë faktike dhe nuk janë të parashikuara me ligj shkaqet e pushimit të saj, ndërsa martesa pushon në mënyrë juridike dhe vetëm për shkaqe të parashikuara me ligj.<sup>157</sup>

---

<sup>156</sup> <https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>, (06.02.2018).

<sup>157</sup> Po aty, (02.06.2018).

## 6.2.Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve jashtëmartesorë në Republikën e Maqedonisë

Bashkësia jashtëmartesore në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë për herë të parë është rregulluar me Ligjin për Familje të vitit 1992. Edhe pse më vonë në krahasim me vendet tjera Evropiane, rregullimi ligjor i bashkësisë jashtëmartesore paraqet një nga rregullat më të rëndësishme në ligjin për familje. Pranimi dhe rregullimi i bashkësisë jashtëmartesore ishte një nga përfitimet e mëdha në periudhën e atëhershme dhe lë pasojë logjike e cila lidhet me statusin e fëmijëve të lindur në bashkësinë jashtëmartesore me fëmijët e lindur në martesë.<sup>158</sup>

Në periudhat e mëhershme bashkësia jashtëmartesore ishte e përjashtuar nga rregullimi ligjor. Megjithatë, në praktikën gjyqësore janë paraqitur raste të ralla, tek të cilët bashkëshortëve jashtëmartesorë u janë njohur të drejta të caktuara pronësore, e cila sjell deri në pyetjen se çfarë ka qenë qëndrimi i shoqërisë për këtë fenomen? Ky fenomen gjithmonë ka qenë në ndryshim varësisht nga zhvillimi i shoqërisë, por, përgjithësisht qëndrimi i shoqërisë ndaj bashkësisë jashtëmartesore ka qenë negativ.<sup>159</sup>

Në ditët e sotme dispozitat që rregullojnë bashkësinë jashtëmartesore në Ligjin për familje nuk kanë asnjë ndryshim në krahasim me ligjin e mëparshëm të vitit 1992.<sup>160</sup>

Nëse bejmë një analizëm për numrin konkret të bashkësive jashtëmartesore në Republikën e Maqedonisë ende nuk ka të dhëna zyrtare. Megjithatë nëse bejmë një krahasim me vendet Skandinave dhe me vendet tjera Evropiane, numri i bashkësisë jashtëmartesore në Maqedoni është dukshëm më i ulët. Kjo është kryesisht për shkak të dominimit të vlerave patriakale të cilët janë ende dominant në shoqërinë tonë. Kjo deklaratë konfirmohet nga numri i vogël i fëmijëve të lindur në bashkësinë jashtëmartesore në Maqedoni, e cila është 12% në vitin 2014.<sup>161</sup>

---

<sup>158</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.159.

<sup>159</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Реформата на наследното право во Република Македонија", Скопје, 2016, fq.84,85.

<sup>160</sup> *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.83/04.

<sup>161</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Реформата на наследното право во Република Македонија", Скопје, 2016, fq.85.

Në të drejtën pozitive, sipas dispozitave të nenit 13 të Ligjit për familje bashkësi jashtëmartesore definohet si: bashkësi e një burri dhe një gruaje, e cila nuk është e themeluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji (bashkësi jashtëmartesore) dhe e cila ka zgjatur së paku 1 vjet, është e barazuar me bashkësinë martesore për sa i përket të drejtës së mbajtjes reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie.<sup>162</sup>

Marrëdhënjet personale në bashkësinë jashtëmartesore edhe pse nuk janë të rregulluara me ligj, asaj i njihen dy lloj të efekteve juridike familjare: efektet juridike të karakterit personal-pasuror – detyrimi për ushqimi dhe efektet juridike të karakterit pasuror – pasuria e përbashët.

Bashkësi jashtëmartesore barazohet me bashkësinë martesore për sa i përket mbajtjes reciproke e cila është e rregulluar me Ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë në nenin 185 deri në nenin 193.

Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqimi dhe është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vet, ka të drejtë në ushqimi nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësitë e tij. Gjykata mund, duke i marrë parasysh të gjithë rrethanat e rastit, ta refuzojë kërkesën për ushqim në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkak të arsyeshëm e ka braktisur bashkëshortin nga i cili kërkon ushqim.<sup>163</sup>

Bashkëshorti i pasiguruar ka të drejtë të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilën shkurorëzohet martesa të gjykohet një shumë e caktuar e të hollave në emër të ushqimit në barrë të bashkëshortit tjetër në proporcion me mundësitë e tij.<sup>164</sup>

Gjykata mund ta refuzojë kërkesën për ushqim nëse këtë e kërkon bashkëshorti i cili pa shkak serioz është sjellur në mënyrë të vrazhdë dhe të padrejtë në bashkësinë martesore ose kërkesa e tij do të paraqes padrejtësi evidente për bashkëshortin tjetër.<sup>165</sup>

E drejta për ushqimi të bashkëshortit të mëparshëm i cili është i pasigurtë, zgjat më së shumti 5 vjet pas shkurorëzimit apo anulimit të martesës. Me kërkesë të bashkëshortit,

---

<sup>162</sup> Neni 13, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.80/92.

<sup>163</sup> Neni 185, po aty.

<sup>164</sup> Neni 186, po aty.

<sup>165</sup> Neni 187, po aty.

gjykata mund ta vazhdojë të drejtën për ushqim edhe pas kalimit të afatit prej 5 vite, nëse vërtetohet se për këtë egzistojnë shkaqe të arsyeshme, e veçanërisht nëse bashkëshorti i pasigurtë edhe pas kalimit të këtij afati nuk do të jetë në gjendje të sigurojë ushqim.<sup>166</sup>

Gjykata mund të vendosë që obligimi për ushqim të zgjasë edhe më pak se 5 vite kur egziston supozimi se kërkuesi i ushqimit ka mundësi që në kohë të caktuar në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë mjete për ushqim. Gjykata ka mund që duke i vlerësuar të gjitha rethanat të vendos që obligimi për ushqim të zgjasë një kohë të caktuar, ose kërkesa për ushqimi të refuzohet në tërësi pa marrë parasysh nëse kërkuesi i ushqimit për kohë të caktuar do të sigurojë mjete për ushqim, gjersa ai nuk ka në përkujdesje fëmijë të mitur të përbashkët.<sup>167</sup>

E drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon, kur të kalojë koha për të cilën është paraparë ushqimi dhe kur bashkëshorti i mëprashëm që pranon ushqimin do të lidhë martesë të re ose do të hyjë në bashkësi jashtëmartesore.<sup>168</sup>

Gjatë vendosjes për dhënje të ushqimit personit nga bashkësia jashtëmartesore në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat e këtij ligji që vlejnë për ushqimin e bashkëshortëve.<sup>169</sup>

Në këtë rast na paraqitet pyetja se çka nënkuptojmë me detyrimet e ushqimit midis bashkëshortëve jashtëmartesorë? Me detyrimin e ushqimit midis bashkëshortëve jashtëmartesorë nënkuptojmë detyrimin e furnizimit të rregullt të bashkëshortit jashtëmartesorë me të mira material me qëllim të plotësimit të nevojave për jetë, por, kjo ndodh vetëm pas pushimit të kësaj bashkësie dhe vetëm kur do të plotësohen kushtet e përgjithshme: bashkëshorti jashtëmartesor të mos ketë mjete për jetë, të jetë i paaftë për punë, apo i papunë etj, dhe kushtet e veçanta: egzistimi i bashkësisë jashtëmartesore, zgjatja e jetës së përbashkët për një kohë të gjatë ose fakti që kanë fëmijë, pushimi i bashkësisë jashtëmartesore dhe mosegzistimi i fajit.<sup>170</sup>

---

<sup>166</sup> Neni 189, *Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.80/92.

<sup>167</sup> Neni 190, po aty.

<sup>168</sup> Neni 191, po aty.

<sup>169</sup> Neni 193, po aty.

<sup>170</sup> <https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>, (06.02.2018).

Efektet e bashkësisë jashtëmartesore në të drejtën trashëgimore mund të vërehen edhe në aspektin pasuror, në pasurinë e përbashkët. Për egzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve jashtëmartesor duhet të plotësohen dy kushte: egzistimi i bashkësisë jashtëmartesore dhe fitimi i pasurisë me punë.<sup>171</sup>

Në ligjin për pronësi dhe të drejtat tjera sendore thuhet se pasurinë të cilët bashkëshortët jashtëmartesorë do të fitojnë në bashkësinë jashtëmartesore konsiderohet si pasuri e përbashkët e tyre. Sa i përket administrimit dhe diponimit, përcaktimit të pjesëve në pasurinë e fituar në bashkësinë jashtëmartesore në mënyrë përkatese zbatohen dispozitat e këtij ligji mbi pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve martesore.<sup>172</sup>

Duke marrë parasysh dispozitat që rregullojnë bashkësinë jashtëmartesore mund të konkludojmë se bashkësia jashtëmartesore është e barabartë me bashkësinë martesore sa i përket të drejtës së mbajtjes reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie.

Për pranimin e bashkësisë jashtëmartesore duhet të merren parasysh jo vetem kohëzgjatja e bashkësisë, por edhe sjellja e partnerëve dhe dëshira e vërtetë e palëve për jetesë të përashkët.<sup>173</sup>

Që bashkëshortëve jashtëmartesorë tu njihet e drejta e mbajtjes dhe pasurisë së përbashkët nuk duhet të egzistojnë pengesa martesore ndërmjet partnerëve, ashtu që partnerët jashtëmartesorë nuk duhet të jenë në ndonjë lidhje tjetër qoftë martesore apo jashtëmartesore, e as ndërmjet tyre të egzistojë afërsi gjini gjaku. Si rezultat nga kjo në praktikën gjyqësore paraqiten shumë raste tjera që vështirësojnë situatën në rastet kur një nga bashkëshortët jashtëmartesorë është ende në lidhje martesore.<sup>174</sup>

P.sh. në qoftë se trashëgimlënësi A.B. gjatë jetës së tij ka qenë në lidhje martesore me personin D.B. me të cilën nuk kanë fëmijë (bashkësi e cila faktikisht ka pushuar por jo juridikisht), kurse bashkëjeton me personin F.E. me të cilën kanë dy fëmijë jashtëmartesorë, gjykata në pajtim me ligjin për trashëgimi, pas vlerësimit të gjithë rrethanave në rastin

---

<sup>171</sup> <https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>, (06.02.2018).

<sup>172</sup> Neni 81, *Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.18/01.

<sup>173</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Реформата на наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2016, fq.86.

<sup>174</sup> По ату, fq.86.

konkret, masën trashëgimore do të ndajë mes personit D.B. bashkëshortit të trashëimlënësit dhe dy fëmijëve jashtëmartesorë, kurse bashkëshorti jashtëmartesorë nuk fiton të drejtën e trashëgimisë.

Në të drejtën krahasuese pothuajse të gjithë vendet e zhvilluara në legjislacionin e tyre parashohin që ndërmjet bashkëshortëve jashtëmartesorë nuk duhet të egzistojnë pengesa martesore. Në Maqedoni për formimin e bashkësisë jashtëmartesore nuk parashohin pengesa martesore, si rezultat i këtij lëshimi të legjislacionit në realitet paraqiten raste kur një person është në lidhje martesore e cila faktikisht pa pushuar por ka edhe bashkëshort jashtëmartesorë, ku është e diskutueshme si do të ndahet pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së këtyre bashkësive.<sup>175</sup>

Pozita juridiko-trashëgimore ka domethënje të madhe pasi që nëse kjo e drejtë u njihet bashkëshortëve atëherë ato përfaqësojnë “*vazhdimin*” e të drejtës pronësore. Në të drejtën pozitive trashëgimore, bashkësia jashtëmartesore nuk është e parashikuar si bazë për trashëgimi ligjore, për shkak të së cilës bashkëshortët jashtëmartesorë nuk mund të paraqiten si trashëgimtar ligjor. Vërehet se në ligj egzistojnë zbrazëtira për shkak të mos rregullimit të pozitës trashëgimore të bashkëshortëve jashtëmartesor si pasojë e së cilës në praktikën gjyqësore paraqiten vështirësi.<sup>176</sup>

Në përputhje me nenin 13 të Ligjit për trashëgimi “masën trashëgimore të të vdekurit e trashëgojnë para se gjithash të gjithë fëmijët e tij dhe bashkëshorti/ja e tij/saj. Ata trashëgojnë pjesë të barabarta.”<sup>177</sup> Duke fillar nga parashikimi ekskluziv vetëm të bashkëshortit martesor në ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë, argumentum a contrario del që bashkëshorti jashtëmartesor i trashëgimlënësit nuk ka asnjë të drejtë trashëgimore.<sup>178</sup>

Duke analizuar Ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë mund të vërejmë se egzistojnë zbrazëtira në ligj përse i përket pozitës së bashkëshortit jashtëmartesorë. Në

---

<sup>175</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Реформата на наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2016, fq.86-87.

<sup>176</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, “Аналогија на вонбрачната заедница со брачна заедница”, Скопје, 2008, fq.296.

<sup>177</sup> Neni 13, *Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë*, gazeta zyrtare nr.47/96.

<sup>178</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.162.

drejtim me këtë shkenca një kohë të gjatë analizon, përpunon dhe përpiket që të bëhen ndryshime në ligjin për trashëgimi me të cilën do të përmirësohet pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë.<sup>179</sup> Kjo situatë është shumë e arsyeshme dhe e nevojshme pasi që në Maqedoni vazhdimisht është duke u rritur numri i bashkëshortëve jashtëmartesor, si dhe numri i fëmijëve të lindur në bashkësitë jashtëmartesore.

Në ligjin për trashëgimi të RM-së mund të vërejmë se pozita e fëmijëve jashtëmartesor është e barabartë me pozitën e fëmijëve martesor por kjo nuk vlen edhe për bashkëshortët jashtëmartesor. Nëse vërehet se ligjdhënësi ka parashikuar mundësinë që edhe personat që jetojnë në bashkësinë e vazhdueshme së paku 5 vite të paraqiten si trashëgimtar pse kjo situatë mos u njihet edhe bashkëshortit jashtëmartesor në kushte të caktuara. Njohja e pozitës trashëgimore të bashkëshortit jashtëmartesor është e nevojshme pasi që i përmbush të gjithë funksionet familjare posaçërisht në ato bashkësi që kanë fëmijë, por sërish autorët si p.sh. Dejan Mickov dhe Angel Ristov janë të mendimit që duhet të përmbushen disa kushte për njohjen e pozitës trashëgimore të bashkëshortëve jashtëmartesorë. Së pari, bashkësia jashtëmartesore duhet të ketë zgjatur një kohë të gjatë të caktuar me ligj dhe së dyti nuk duhet të egzistojë pengesa martesore ndërmjet partnerëve jashtëmartesorë.<sup>180</sup>

Për këtë problematikë duhet gjetur një zgjidhje sipas së cilës përdërisa bashkësia jashtëmartesore ka zgjatur së paku 5 vite deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëshorti jashtëmartesor do të fitoj të drejtën e trashëgimisë, analoge me dispozitat për bashkëshortin martesor në trashëgiminë ligjore. Në rastet kur në bashkësinë jashtëmartesore ka edhe fëmijë të lindur në atë bashkësi, atëherë afati për kohëzgjatje të bashkësisë duhet të jetë më i shkurtër, përkatësisht duhet të parashikohet një afat prej 3 vitesh deri në vdekje të trashëgimlënësit. Ligjdhënësi duhet t'i plotësojë zbrazëtirat ligjore sipas së cilës edhe bashkëshorti jashtëmartesor do të paraqitet si trashëgimtar në radhën e parë dhe në radhën e dytë të trashëgimisë, njëjtë si edhe bashkëshorti martesor. E nëse nuk ka trashëgimtar tjerë (fëmijët dhe prindërit) në radhën e parë dhe në radhën e dytë atëherë bashkëshorti

---

<sup>179</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2010, fq.79.

<sup>180</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Реформата на наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2016, fq.87-88.



jashtëmartesor do t'i përjashtojë trashëgimtarët e rendit të tratë dhe do të trashëgojë tërë masën trashëgimore.<sup>181</sup>

Praktika gjyqësore ballafaqohet me prova të gjera dhe të vështira për egzistencën dhe kohëzgjatjen e bashkësisë jashtëmartesore.<sup>182</sup>

Qëndrimi i shkencës juridike është që ligdhënësi tu mundësojë bashkëshortëve jashtëmartesorë të cilët dëshirojnë ti largohen vështirësive të mundshme gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, lidhjen e tyre ta formalizojnë me deklaratën e dyanshme të çertifikuar dhe depozituar me noter. Kjo deklaratë e çertifikuar në noter do të lehtësojë dëshmimin e egzistencës dhe kohëzgjatjes të bashkësisë jashtëmartesore.<sup>183</sup>

Mund të konkludohet se në Republikën e Maqedonisë pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë në të drejtën trashëgimore është anashkaluar tejmasë e cila në ditët e sotme është një fenomen aktual në rritje e sipër për këtë shkak ligdhënësi duhet që në Ligjin për trashëgimi të RM-së nëpërmjet dispozitave të reja të përmirësojë pozitën e bashkëshortëve dhe të mundësojë që edhe ato të paraqiten si trashëgimtar si edhe bashkëshortët martesorë sepse nuk është e mjaftueshme vetëm barazia e partnerëve jashtëmartesor me ato martesorë në aspektin e ushqimisë dhe pronës së përbashkët.

Sa i përket çështjes për bashkësitë mes personave të të njëjtit seks në vendin tonë, në kushte të rezidencës së forte ndaj njohjes së të drejtës së këtyre bashkësive, duket se ende nuk janë pjekur kushtet për rregullimin ligjor të tyre. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ato duhet të rregullohen në kohën e duhur, duke marrë parasysh parimin e sigurisë juridike, parimin e mosdiskriminimit, fakti se Republika e Maqedonisë ka pranuar Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe faktin e aspiratës së vendit tone që të jetë antar i Unionit Europian, ku në numrin e madh të vendeve kanë rregulluar me ligj bashkësinë e personave të të njëjtës gjini.<sup>184</sup>

---

<sup>181</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *"Наследното право во Република Македонија"*, Скопје, 2010, fq.80.

<sup>182</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *"Наследувањето во Европа"*, Скопје, 2011, fq.163.

<sup>183</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *"Наследувањето во Европа"*, Скопје, 2011, fq.163-164.

<sup>184</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *"Наследното право во Република Македонија"*, Скопје, 2010, fq.81.

### 6.3. Të dhëna statistikore për bashkëshortët jashtëmartesorë

Në kohën e fundit aktualiteti i bashkësisë jashtëmartesore solli deri në analizim më të detajuar të këtij fenomeni.

Sipas të dhënave statistikore të vitit 1950 në Brazil, numri i bashkëshortëve jashtëmartesorë është 25% kundrejt numrit të bashkëshortëve martesorë. Ky numër është më i madh në vendet Latino Amerikane.

Në vendet Evropiane, p.sh.në Haiti egzistojnë 314 bashkësi jashtëmartesore kundër 100 bashkësive martesore, si vend me përqindje më të madhe të bashkësisë jashtëmartesore është llogaritur Venediku me 71 bashkësi jashtëmartesore kundër 100 bashkësive martesore.

Përqindja e bashkësive jashtëmartesore posaçërisht është e madhe në vendet Skandinave në Europë (Danimarkë, Suedi, Norvegji), ku 50% e fëmijëve janë lindur në bashkësitë jashtëmartesore.

Në Japoni numri i bashkësive jashtëmartesor është në rritje. Kështu në vitet 70 të shekullit XX është llogaritur se numri i fëmijëve jashtëmartesor ka qenë 30%, ku numër i madh i tyre kanë jetuar në vende urbane.

Në vitet e fundit rritet numiri i vendeve që ligjërisht rregullojnë edhe bashkësitë e personave të të njëjtës gjini në formë të bashkësive të regjistruara. Disa vende shkojnë edhe një hap para duke u mundësuar partnerëve të të njëjtës gjini të drejta që të lidhin martesë, por, jo vetëm aq, u mundësojnë edhe të drejta të tjera si p.sh.të adoptojnë fëmijë, detyrime prindërore etj.<sup>185</sup>

Përdesira vërejmë zhvillimin e legjislativës së shumë vendeve në realitetin aktual në Maqedoni ende nuk egzistojnë kushte për realizimin e këtyre të drejtave.

Në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistik, numri i martesave në vitin 2016 në krahasim me vitet e kaluara është zvogëluar për 7.0 %

---

<sup>185</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.203.

dhe arrin 13.199 martesë. Shumica e martesave janë lidhur në muajin gusht 1721 ose 13,0%, kurse më pak në muajin prill vetëm 637 ose 4.8 % martesë.

Nga martesat e regjistruara më e shpeshta është lidhja e martesës për herë të parë me pjesëmarrje prej 92,5% për burrat. Në lidhjen e martesës së dytë ky numër përfshin 8,1% dhe martesë e tretë 0,7% në numrin e përgjithshëm të martesave, ku në këtë numër më së shpeshti gjinia mashkullore dominon.

Në vitin 2016 në numrin e martesave të lidhura gratë kanë qenë në moshën prej 20 deri në 24 me pjesëmarrje prej 33,7 % kurse meshkujt në moshën prej 25 deri në 29 me pjesëmarrje prej 37,1 %.

Numri i shkurorëzimeve në vitin 2016 zvogëlohet me 9,8 % krahasuar me vitin 2015, duke arritur në 1985 martesë të shkurorëzuara. Shkurorëzime më të pakta gjatë vitit ka në qeshor që përfshin 39 ose 2,0 % dhe shkurorëzime më të shumta në mars që përfshin 245 ose 12,3%.

Numri i shkurorëzimeve sipas moshës tek gratë paraqiten në moshën 25 deri në 29 vjet, me pjesëmarrje prej 18,6 % dhe numri i shkurorëzimeve sipas moshës së burrit përfshin në grupmoshën prej 35 deri 39, me pjesëmarrje prej 18,0 %.<sup>186</sup>

Në Republikën e Maqedonisë numri i bashkëshortëve jashtëmartesorë është në rritje, kjo vërehet nga të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave ku rreth 12 % e numrit të përgjithshëm të fëmijëve janë fëmijë jashtëmartesorë. Kjo përqindje në shtetet antare të Unionit Europian është 40 %.<sup>187</sup>


Sipas të dhënave të Eurostatit të vitit 2013, 4 nga 10 fëmijë të lindur në Europë janë fëmijë jashtëmartesorë. Ky numër është në rritje e sipër. Përqindje më të madhe 69 % - 79 % kemi në Islandë, pastaj në Suedi, Danimarkë, Norvegji, Francë, Portugali, Slloveni, Estoni dhe Bullgari. Ky trend nuk është aktual në Greqi, Bosnë dhe Hercegovinë, Kroaci,

---

<sup>186</sup>Të dhëna nga Enti Shtetëror për Statistikë <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbrtxt=11>, e publikuar në 17.05.2017, (08.01.2018).

<sup>187</sup> <http://mkd-news.com/dete-da-brak-ne-zgolemen-brojot-na-vonbrachni-detsa-vo-makedonija/>, (07.02.2018).

Malit të Zi, Maqedoni dhe Turqi ku përqindja e fëmijëve të lindur në bashkësitë jashtmartesore është më pak se 20 %.<sup>188</sup>



Nga numri i fëmijëve jashtëmartesorë mund të kuptohet që aktualiteti i bashkësisë jashtmartesore në vendin tone është më i ulët por në krahasim me vitet e kaluara kemi rritje në numrin e fëmijëve jashtëmartesorë. Për krahasim me vendet tjera evropiane, ku bashkësinë jashtmartesore e rregullojnë ligjërisht edhe në aspektin trashëgimor, në Republikën e Maqedonisë egziston zbrazëtira në ligj, ashtu që egzistojnë tendenca që bashkësia jashtëmartesore të rregullohet ligjërisht edhe në vendin tonë.

<sup>188</sup> <https://kajgana.com/trendot-na-ragjanje-deca-vo-vonbrachna-zaednica-pretstaven-na-mapa>, (07.02.2018).

#### 6.4. Rregullimi juridiko-trashëgimor i bashkësisë jashtëmartesore në të drejtën krahasuese

Legjislacioni i parë në territorin Europian që e njohu bashkësinë jashtëmartesore dhe në përgjithësi e barazoi me bashkësinë martesore është e drejta Suedeze. Ky hap i ligjdhënësve Suedez me sjelljen e ligjit për familje të vitit 1970 shkaktoi tronditje të madhe, ku këto ndryshime paten ndikim direkt në aspektin juridiko-trashëgimor të bashkëshortëve martesorë. Me këtë pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë u barazua me pozitën e bashkëshortëve martesor edhe në aspektin trashëgimor.

Pas Suedisë, bashkësia jashtëmartesore si bazë për trashëgiminë ligjore ishte parashikuar gjithashtu në ligjin e trashëgimisë të ish-KSA e Kosovës të vitit 1974. (ish Krahina Socialiste e Kosovës ishte zgjidhja administrative e një pjese të territorit të Kosovës që nga viti 1968 deri në shpërbërjen e RSFJ 1989. Ky lloj i administrimit të territorit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, kishte një shkallë më të madhe të vetqeverisjes me Kushtetutën e vitit 1974).<sup>189</sup>

Në pajtim me këtë ligj, që bashkëshorti pasjetues jashtëmartesor të mund të paraqitet si trashëgimtar duhet të përmbushen 4 kushte:

1. bashkësia jashtëmartesore mes një burri dhe një gruaje duhet t'i kishin të gjithë tiparet e dukshme të bashkëshortëve martesor.
2. Bashkësia jashtëmartesore të egzistonte deri në momentin e vdekjes së njërit nga partnerët jashtëmartesor.
3. Të egzistojë së paku 15 vite, e nëse kanë fëmijë së paku 5 vite.
4. Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, asnjë nga partnerët jashtëmartesorë mos jenë në lidhje martesore me personat e tretë ose bashkëshorti që është në lidhje martesore të ketë paraqitur padi për shkuroëzim e pas vdekjes të vërtetohet se padia është e bazuar.

Në këtë mënyrë bashkësisë jashtëmartesore i dhanë kuptim të njëjtë si bashkësia martesore.<sup>190</sup>

---

<sup>189</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Krahina\\_Socialiste\\_Autonome\\_e\\_Kosovës](https://sq.wikipedia.org/wiki/Krahina_Socialiste_Autonome_e_Kosovës), (07.02.2018).

<sup>190</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Реформата на наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2016, fq.80-81.

Legjislacioni tjetër që njohi bashkësinë jashtëmartesore ishte e drejta sllovene, me Ligjin për trashëgimi të Sllovenisë të vitit 1976, e cila vlen edhe në ditët e sotme. Në pajtim me neni 10 paragrafi 2 të këtij ligji, bashkësia jashtëmartesore paraqitet si bazë për trashëgimi ligjore. Në këtë drejtim, që të mund bashkëshortët jashtëmartesorë të paraqiten trashëgimtarë është e nevojshme që bashkësia e tyre të zgjasë një kohë të gjatë dhe të mos egzistojnë pengesa. Bashkëshortët jashtëmartesorë fitojnë të drejta trashëgimore si edhe partnerët martesorë në radhën e parë dhe të dytë të trashëgimisë.<sup>191</sup>

Sipas teorisë franceze, *konkubinat apo bashkësi e lire (union libre)*, paraqet bashkësi jashtëmartesore e cila karakterizohet me një qëndrueshmëri të caktuar dhe stabilitet. Konkubinat paraqet bashkësi faktike apo bashkësi jetese e përbashkët, stabile, e vazhdueshme mes dy personave me gjini të kundërt apo të njëjtë që jetojnë në çift.<sup>192</sup>

Në të drejtën krahasuese egzistojnë dy lloj të bashkësive jashtëmartesore të regjistruara dhe të paregjistruara. Në Francë, por, edhe në numër të madh të legjislacioneve tjera që të mund bashkëshortët jashtëmartesorë të shfrytëzojnë të drejtat tjera familjare dhe sociale është e nevojshme që të vërtetojnë bashkësitë e tyre. Dëshmi për vërtetimin e egzistencës së bashkësisë së tyre është çertifikata (certificate de concubinage) e cila jepet nga zyrat e kryetarëve të komunave. Në lidhje me trashëgiminë, bashkëshortët jashtëmartesorë nuk kanë të drejtë në trashëgimi reciproke mes tyre. Megjithatë, vdekja e njërit prej partnerëve në raste të caktuara, mund të ketë pasoja të caktuara pasurore. Në këtë drejtim praktika gjyqësore pranon që në rast të vdekjes së njërit nga partnerët për shkak të ndonjë aksidenti, partneri tjetër të kërkoj kompensim material apo moral.<sup>193</sup>

Me sjelljen e Ligjit për trashëgimi të vitit 2003, legjdhënësi Kroat ia njohu bashkëshortëve jashtëmartesorë trashëgiminë ligjore. Me këtë e drejta trashëgimore Kroate bashkëshortin jashtëmartesor e barazon me bashkëshortin martesorë për gjithë marrëdhënjet *inter vivos dhe mortis causa*. Në pajtim me ligjin për trashëgimi me

---

<sup>191</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Реформата на наследното право во Република Македонија", Скопје, 2016, fq.81.

<sup>192</sup> Neni 518-8, Kodi Civil Francez.

<sup>193</sup> Трпеновска - Спиоровиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.208-209.

bashkësinë jashtëmartesore kuptojmë bashkësi jetese e gruas së pamartuar dhe burrit të pamartuar e cila ka zgjatur një kohë të gjatë, kurse ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, me kusht të jenë plotësuar pretendimet që janë të vlefshme për martesë. Me këtë kuptojmë se përderisa egzistojnë pengesa martesore ose bashkësia jatesësore nuk ka zgjatur deri në vdekjen e njëri prej tyre, bashkëshortët jashtëmartesorë nuk do të kenë të drejta trashëgimore. Ligji kroat për trashëgimi nuk e parashikon periudhën kohore të zgjatjes së bashkësisë jashtëmartesore, si rezultat i kësaj praktika gjyqësore në mënyrë analoge zbaton dispozitat e nenit 3 të ligjit për familje sipas së cilës me bashkësinë jashtëmartesore kuptojmë bashkësi jetese e burrit dhe gruas së pamartuar që jetojnë në bashkësi jetese të përbashkët e cila ka zgjatur sëpaku 3 vjet apo më pak nëse në atë bashkësi ka fëmijë.<sup>194</sup>

Ligji i ri për trashëgimi i Kosovës i vitit 2004, ngjajshëm me ligjin e mëparshëm me ndryshime të vogla e rregullon statusin e bashkëshortëve jashtëmartesorë. Ligjdhënësi parashikon që trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti jashtëmartesorë i/e cili/cila barazohet me bashkësinë martesore.

Legjislacioni Kosovar parashikon kushte më konkrete që bashkëshortëve jashtëmartesorë të paraqiten si trashëgimtar. Bashkëshortët jashtëmartesorë kanë të drejta që të paraqiten si trashëgimtar reciprok si edhe bashkëshortët martesor nëse:

- a) Nëse bashkësia jashtëmartesore me trashëgimlënësin, deri në momentin e vdekjes së tij ose saj ka zgjatur së paku 10 vite ose 5 vite nëse në atë bashkësi ka fëmijë
- b) Nëse në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit asnjë nga partnerët e bashkëshortëve jashtëmartesorë nuk ka qenë në bashkësi të vlefshme martesore me person të tretë, ose në rastet kur trashëgimlënësi ka qenë në bashkësi të vlefshme martesore me person të tretë, ose në rastet kur trashëgimlënësi ka qenë në bashkësi martesore me person të tretë por ka paraqitur padi për shkuorëzim e pas vdekjes së trashëgimlënësit padia vërtetohet se është e bazuar.

Ligji për trashëgimi parashikon se bashkëshortët jashtëmartesorë nuk janë edhe trashëgimtar të domosdoshëm (neni 28 paragrafi 2). Bashkëshorti jashtëmartesor nuk do

---

<sup>194</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Реформата на наследното право во Република Македонија", Скопје, 2016, fq.83.

të jetë trashëgimtar nëse bashkësia nuk ka zgjatur për periudhë të caktuar (neni 28 paragrafi 2).<sup>195</sup>

Ligji për trashëgimi i Malit të Zi të vitit 2008, gjithashtu parashikon bashkësinë jashtëmartesore si bazë për trashëgimi ligjore. Statusi i bashkëshortëve jashtëmartesore barazohet me statusin e bashkëshortëve martesore, përderisa bashkësia jetese ka zgjatur një periudhë të caktuar, mes partnerëve nuk ka pasur pengesa martesore dhe ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit.

Shumica e vendeve Evropiane bashkëshortëve jashtëmartesorë nuk ia njohin të drejtën trashëgimore, edhe në SHBA vetëm e drejta e Nju Hemshit parashikon trashëgimi ligjore bashkëshortëve jashtëmartesorë pas 3 viteve të bashkësisë së përbashkët. Përveç vendeve të theksuara trashëgiminë ligjore bashkëshortëve martesorë e pranojnë vendet si Kanada (Ontario, Succession Law reform art), Izraeli dhe Australia (Inheritance Law).<sup>196</sup>

---

<sup>195</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Наследувањето во Европа”*, Скопје, 2011, fq.208-210-211.

<sup>196</sup> Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, *“Реформата на наследното право во Република Македонија”*, Скопје, 2016, fq.84.



## KAPITULLI V

### 7. POZITA JURIDIKO TRASHËGIMORE E BASHKËSHORTËVE MARTESORË DHE JASHTËMARTESORË NË TË DREJTËN KRAHASUESE

#### 7.1. Pozita juridiko-trashëgimore e bashkëshortëve martesorë në vendet Europiane

##### 7.1.1. Gjermani

E drejta trashëgimore në Gjermani rregullohet me Kodin Civil Gjerman *Deutschen Bürgerlichen Gesetzbuch* (BGB) i cili u miratua në vitin 1896 dhe hyri në fuqi në 1 janar të vitit 1900. E drejta trashëgimore rregullohet me librin e pestë, por edhe me rregulla të tjera që përmbajnë dispozita ligjore trashëgimore.

Neni 1922/1 i Kodit Civil Gjerman thotë: “Me vdekjen e një personi, prona e atij personi (trashëgimia) kalon si një e tërë në një ose më shumë personave të tjerë (trashëgimtarët).” Kanë të drejtë të jenë trashëgimtar vetëm personat që kanë lindur gjallë në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe personat, të cilët nuk janë gjallë në momentin e çeljes së saj, por janë konceptuar dhe kanë lindur gjallë përpara çeljes së saj.<sup>197</sup>

E drejta trashëgimore në Ligjin Gjerman mund të fitohet në bazë të ligjit, testamentit dhe kontratës trashëgimore. Karakteristike për ligjin për trashëgimi gjermane për dallim nga tjerët është se parashikon numër të pafund të rendeve trashëgimore.<sup>198</sup>

Sipas Kodit civil Gjerman në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë vullnetin e tij/saj të fundit (testament), trashëgimtarët në rendin e parë të trashëgimisë janë pasardhësit, nëse nuk ka pasardhës trashëgojnë prindërit dhe pasardhësit e tyre, e në qoftë se as ato nuk egzistojnë atëherë trashëgojnë anëtarët e tjerë të familjes.

Në të drejtën gjermane, për shkak të faktit se bashkëshorti nuk është lidhur me trashëgimlënësin me lidhje gjaku, e drejta e tij/saj për trashëgimi është subjekt i rregullave të posaçme ose të veçanta. Kështu, bashkëshorti pasjetues ka të drejtë në trashëgimi të ¼ të masës trashëgimore kur konkuron me trashëgimtarët e rendit të parë (pasardhësit),

---

<sup>197</sup> Neni 1923 i Kodi Civil Gjerman (*Deutschen Bürgerlichen Gesetzbuch, Aufgebotsverfahren*, January 1, 1900).

<sup>198</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.80-81.

gjysmën e masës trashëgimore kur konkuron me prindërit në rendin e dytë në vijë të drejtë dhe të tërthortë (prindërit, vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit me pasardhësit e tyre) në qoftë se janë gjallë gjyshërit dhe gjyshet atëherë bashkëshorti trashëgon  $\frac{3}{4}$  nga masa trashëgimore, e në mungesë të trashëgimtarëve tjerë bashkëshorti e trashëgon tërë masën trashëgimore. Bashkëshorti pasjetues ka përparësi për fitimin e sendeve shtëpiake, si dhe dhuratat nga martesë, poashtu ka përparësi edhe për fitimin e shtëpisë së përbashkët.<sup>199</sup>

<u>Subjektet që konkurojnë me bashkëshortin pasjetues.</u>	<u>Pjesa trashëgimore që i takon trashëgimtarëve.</u>	<u>Pjesa trashëgimore që i takon bashkëshortit.</u>
Trashëgimtarët në rendin e parë të trashëgimisë.	$\frac{3}{4}$	$\frac{1}{4}$
Trashëgimtarët në rendin e dytë të trashëgimisë.	$\frac{1}{2}$	$\frac{1}{2}$
Trashëgimtarët e tjerë (në mungesë të trashëgimtarëve të rendit të parë dhe të dytë).	/	Gjithë masën trashëgimore

200

Pozita e bashkëshortit pasjetues varet edhe nga regjimi i pasurisë së përbashkët të fituar gjatë kohës së martesës. Në rastet kur një nga bashkëshortët vdes atëherë principi i ndarjes në pjesë të barabarta të pasurisë së fituar në martesë do të ndihmojë në rritjen e masës trashëgimore në  $\frac{1}{4}$  e trashëgimisë, pa marrë parasysh se a e kanë fituar pronën apo jo. Në qoftë se martesë është lidhur me regjimin e ndarjes së pasurisë, kurse në atë bashkësi ka edhe fëmijë (1 apo 2 fëmijë), bashkëshorti pasjetues e ndan pasurinë me fëmijtë në pjesë të barabarta, e në rastet kur kanë më shumë fëmijë atëherë bashkëshorti pasjetues fito  $\frac{1}{4}$  e pasurisë trashëgimore, kurse pjesa tjetër ndahet mes fëmijëve.<sup>201</sup>

<sup>199</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.84-85.

<sup>200</sup> По ату, fq.85.

<sup>201</sup> По ату, fq.85.

Për bashkëshortin pasjetues vlen një rregull i veçantë. Ligji parashikon që nëse bashkëshortët kanë jetuar nën një regjim ligjor të raporteve pasurore, në të ashtuquajturën "Zugewinngemeinschaft–bashkësi e plusvlerave" parashikon:

- $\frac{1}{2}$  e trashëgimisë nëse ka pasardhës (fëmijë);
- $\frac{3}{4}$  e trashëgimisë nëse ka trashëgimtarë nga ana e prindërve ose pasardhës të tyre;
- $\frac{3}{4}$  e trashëgimisë nëse janë trashëgimtarë gjyshërit;
- $\frac{3}{4}$  e trashëgimisë + kuota e xhaxhallarëve dhe pasardhës të tyre nëse ka një gjysh dhe trashëgimtarë nga ana e xhaxhallarëve;

Kodi Gjerman nuk parashikon trashëgimi ligjore bashkëshortit jashtëmartesorë. Sipas legjislacionit gjerman që bashkëshorti pasjetues të paraqitet si trashëgimtar i masës trashëgimore është e domosdoshme që të përfshihet në testament ( në vullnetin e fundit të trashëgimlënësit), në këtë mënyrë bashkëshorti jashtëmartesor mund të paraqitet trashëgimtar, përndryshe bashkëshortët jashtëmartesorë nuk janë trashëgimtar ligjor sipas Kodit Gjerman.<sup>202</sup>

---

<sup>202</sup> [www.succession-europe.eu](http://www.succession-europe.eu), (04.03.2018).

### 7.1.2. Fransa

Kodi Civil (Code Civil) i vitit 1804 është kodi më i rëndësishëm i të drejtës civile dhe paraqet aktin juridik monumental jo vetëm për kohën e vet, por edhe për kohën e sotme, si akt juridik bashkëkohor. Kodi Civil Francez, edhe sot është në fuqi, kuptohet me ndryshimet dhe plotësimet e bëra gjatë (200) dyqindë vjet të egzistencës së tij.<sup>203</sup>

Legjislacioni Francez në dispozitat e tij parashikon dy lloje të fitimit të trashëgimisë – ligjore dhe trashëgimore. Në të drejtën Franceze trashëgimia hapet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Faktori kryesor që ndikon në formimin e rrethit të trashëgimtarëve ligjor është gjinia e gjakut. Në Kodin Civil trashëgimtarët ligjor janë të ndarë në 4 rende të cilët rënditen njëri pas tjetrit.<sup>204</sup>

- Në rendin e parë hyjnë: fëmijët, pasardhësit e tjerë të trashëgimlënësit pa marrë parasysh preardhjen e tyre (martesore, jashtmartesore apo të adoptuar). Fëmijët e trashëgimlënësit trashëgojnë në pjesë të barabarta.
- Në rendin e dytë të trashëgimisë hyjnë: prindërit e trashëgimlënësit nëna dhe babai, vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësi.
- Në rendin e tretë të trashëgimisë hyjnë: gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta.
- Në rendin e katërt të trashëgimisë hyjnë: kushërinjtë anësorë axhallarët, dajat, tezet dhe hallat e trashëgimlënësit.<sup>205</sup>

Në kodin civil francez bashkëshorti i mbijetuar ligjërisht trashëgon të drejtën e uzurfruktit në rastet kur konkuron me trashëgimtarët në tre rende ligjore.<sup>206</sup>

---

<sup>203</sup> Aliu Abdulla, “E drejta civile”, Prishtinë, 2013, fq.67.

<sup>204</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.87.

<sup>205</sup> Neni 731-755, Kodi Civil Francez.

<sup>206</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.90.

Pozita e bashkëshortit të mbijetuar paraqitet në tabelat e mëposhtme:

- Pozita e bashkëshortit pasjetues në pani të fëmijëve

Bashkëshorti pasjetues	Fëmijët
1/4 e të drejtës së uzurfruktit	1/4 e të drejtës së uzurfruktit + 3/4 në pronësi të plotë

- Pozita e bashkëshortit pasjetues në prani të prindërve të trashëgimlënësit

Bashkëshorti pasjetues	Prindërit e trashëgimlënësit
1/2 e të drejtës së uzurfruktit	1/2 e të drejtës së uzurfruktit + 1/2 në pronësi të plotë

- Pozita e bashkëshortit në prani të dy prindërve dhe kushërinjve anësorë

Bashkëshorti pasjetues	Prindërit e trashëgimlënësit	Kushërinjve anësorë e trashëgimlënësit
1/2 e të drejtës së uzurfruktit	1/2 e të drejtës në pronësi të plotë	1/2 e të drejtës së uzurfruktit

Kjo pozitë e bashkëshortit martesor egzistonte deri në momentin e miratimit të ligjit të 3 dhietorit të vitit 2001 si pjesë e reformave të Kodit Civil, sipas së cilës u mundësua më shumë të drejta në favor të bashkëshortit pasjetues.

Shtëpia e përbashkët hyn në trashëgimi në këto raste:

- 1) Bashkëshorti pasjetues mund ta shfrytëzojë shtëpinë e përbashkët, duke përfshirë edhe mobiljet dhe sendet shtëpiake deri në momentin e vdekjes së tij/saj dhe
- 2) Bashkëshorti pasjetues mund ta shfrytëzojë shtëpinë e përbashkët, mobiljet në afat prej 1 viti, kurse gjatë kësaj periudhe është i detyruar ta pagojë qiranë pronarit të shtëpisë.

Ligji i ri parashikon pjesë më të madhe të trashëgimisë bashkëshortit, në këtë drejtim bashkëshorti pasjetues ka mundësi zgjedhjeje:

- 1) Të fitoj të drejtën e pronësisë në  $\frac{1}{4}$  nga masa trashëgimor e
- 2) Të fitoj të drejtën e uzurfruktit në gjithë masën trashëgimore.

Në rastet kur bashkëshorti konkuron me prindërit e trashëgimlënësit, atëherë bashkëshorti fiton gjysmën e masës trashëgimore, në rastet kur në jetë është vetëm njëri prej prindërve dhe nuk kanë pasardhës tjerë (vëllezër apo motra të trashëgimlënësit), pjesa e bashkëshortit pasjetues është  $\frac{3}{4}$  e të drejtës së pronësisë. Në rastet kur asnjë nga prindërit nuk janë në jetë, kurse në trashëgimi janë thirur bashkëshorti pasjetues dhe pasardhësit e prindërve (vëllezërit apo motrat e trashëgimlënësit), atëherë bashkëshorti pasjetues e trashëgon gjithë masën trashëgimore.<sup>207</sup>

---

<sup>207</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.90-91.

### 7.1.3.Italia

Burimi kryesor për të drejtën trashëgimore ne Itali është Kodi Civil, i cili është në fuqi prej 16 marsit të vitit 1942. E drejta trashëgimore është e rregulluar me librin e dytë e emëruar “për trashëgiminë” (*Delle succession*). Barrtja e trashëgimisë bëhet në bazë të ligjit (*succession natural*) dhe në bazë të testamentit (*succession testamentaria*).<sup>208</sup>

Në mungesë të testamentit, në të drejtën italiane vlejnë rregullat e mëposhtme:

- Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka bashkëshort dhe fëmijë: trashëgiminë e trashëgojnë prindërit e tij dhe pasardhësit e tyre - vëlezërit, motrat e trashëgimlënësit.<sup>209</sup>
- Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort kurse ka fëmijë: gjithë pasurinë trashëgimore e trashëgojnë fëmijët.<sup>210</sup>
- Në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë bashkëshortin por jo edhe fëmijë, pasardhës të tyre, prindër dhe pasardhësit e tyre: bashkëshortit i takon e gjithë masa trashëgimore.<sup>211</sup>
- Në qofrë se trashëgimlënësi ka lënë bashkëshortin/ten dhe fëmijë : bashkëshorti ka të drejtë në gjysmën e pasurisë në rastet kur konkuron me një fëmijë, kurse në rastet kur konkuron me dy ose më shumë fëmijë bashkëshorti trashëgon 1/3.<sup>212</sup> Masa pasurore e mbetur ndahet mes fëmijëve të trashëgimlënësit. Pjesa e masës trashëgimore që do ti takonte fëmijës i cili nuk e ka mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë pasardhësit e tij sipas së drejtës së përfaqësimit (nipërit, mbesat).
- Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka fëmijë, por ka bashkëshorten, prindërit dhe pasardhësit e tyre: 2/3 e trashëgon bashkëshorti kurse 1/3 e trashëgojnë prindërit.<sup>213</sup> Në rastet kur ka edhe vëllezër dhe motra, 2/3 e masës trashëgimore i takon bashkëshortit kurse pjesa tjetër ndahet mes prindërve dhe pasardhësve të tyre.<sup>214</sup>

<sup>208</sup> Трпеновска - Спиоровиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.99-101.

<sup>209</sup> Neni 571, *Kodi Civil Italian*, 1942.

<sup>210</sup> По аты, neni 566.

<sup>211</sup> По аты, neni 583.

<sup>212</sup> По аты, neni 581.

<sup>213</sup> По аты, neni 579.

<sup>214</sup> [www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/](http://www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/), (04.03.2018).

Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të jetojë në shtëpinë e përbashkët dhe të shfrytëzojë sendet shtëpiake, të cilat kanë qenë në pronësi të përbashkët apo vetëm në pronësi të trashëgimlënësit.

Sipas nenit 9 të ligjit për mbështetje, gjykata, në bazë të rrethanave, mund që bashkëshortit nga martesë e shkurore të caktojë një shumë të caktuar në trashëgimia, varësisht nga numri i trashëgimtarëve dhe gjendja materiale e tyre.<sup>215</sup>

Legjislacioni Italian nuk e njeh bashkësinë jashtëmartesore. Bashkëshortët jashtëmartesorë nuk kanë të drejtën e trashëgimisë ligjore në legjislacionin Italian. E drejta e trashëgimisë bashkëshortit jashtëmartesorë mund ti njihet vetëm me testament.<sup>216</sup>

---

<sup>215</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.101.

<sup>216</sup> [www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/](http://www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/), (04.03.2018).



## 7.2 Pozita juridiko trashëgimore e bashkëshortëve martesorë në vendet Anglo – Saksone

### 7.2.1. Britania e Madhe

Në të drejtën trashëgimore të Britanisë së Madhe egzistojnë tri të drejta trashëgimore të ndara nën jurisdiksionin e Skocisë, Anglia dhe Uelsi dhe Irlanda e Veriut.

E drejta trashëgimore e Anglisë dhe Uelsit, të Irlandës së Veriut janë të përafërta për shkak se bazohen në të njëjtën traditë të Comman Law-it. E drejta trashëgimore Skoceze dallohet dukshëm nga të drejtat e tjera pasi që rrënjët e të drejtës trashëgimore bazohen në të drejtën civile të së drejtës romane.

Dallimet qëndrojnë në sistemet e ndryshme të së drejtës së pronësisë në të cilën bazohet e drejta trashëgimore dhe në regjimet e ndryshme në të drejtën familjare.<sup>217</sup>

#### 7.2.1.1. Skocia

E drejta trashëgimore në Skoci i ka specifikat e veta. Sistemi ligjor i Skocisë përbëhet nga një përzierje e Comman law-it dhe disa principe të caktuara nga sistemi civil law që dalin nga e drejta romake.

Në Skoci janë paraparë tre lloje të rregullave para ndarjes përfundimtare të trashëgimisë. Me pagimin e tatimeve, borxheve dhe detyrimeve të tjera të trashëgimlënësit, pasuria e mbetur ndahet në bazë të këtyre principeve:

- 1) Të drejtat prioritare (*prior rights*)
- 2) Të drejtat ligjore (*legal rights*)
- 3) Trashëgimia ligjore (*succession of the free legal estate*)

➤ **Të drejtat prioritare**

Përparësi për trashëgimi ligjore sipas rregullës kanë: bashkëshorti/tja apo partneri civil. Bashkëshorti/tja ka të drejtë në shumë monetare fikse nga masa trashëgimore të caktuar me ligj.

---

<sup>217</sup>Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследувањето во Европа”, Скопје, 2011, fq.108.

Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë në shtëpi të përbashkët në vlerë prej 300 000 funta apo në kundërvlerë në të holla, me një kusht të ketë jetuar me trashëgimlënësin në momentin e vdekjes në shtëpinë e përbashkët. Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë në mobiljet dhe sendet shtëpiake në vlerë prej 24 000 funta, dhe në fund bashkëshorti pasjetues ka të drejtë në një vlerë me të holla prej 75 000 funta ne qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës me të drejtë të përfaqësimit.

➤ **Të drejtat ligjore**

Bashkëshorti pasjetues apo parneri civil, fëmijët dhe pasardhësit e tyre kanë të drejtë në trashëgimi ligjore dhe testamentare rendi i të cilëve vijnë pasi të jenë plotësuar të drejtat prioritare.

➤ **Trashëgimia ligjore**

Neto trashëgimia ligjore paraqet pasurinë e cila mbetet pas pagimit të detyrimeve, të drejtave prioritare dhe të drejtave civile. Nga neto pagohen të afërmit e farefnisës të trashëgimlënësit sipas rendit të mëposhtëm: 1) fëmijët 2) prindërit 3) të afërmit në rast se prindërit nuk janë në jetë 4) prindërit në rastet kur fëmijët nuk e kanë mbijetuar trashëgimlënësin 5) bashkëshorti pasjetues apo parneri civil 6) të afërmit e tjerë.

Nëse trashëgimlënësi nuk i ka mbijetuar pasardhësit e tij apo të afërmit e tjerë me të drejta prioritare atëherë gjithë masën trashëgimore e trashëgom bashkëshorti pasjetues.<sup>218</sup>

Në vitin 1990 Komisioni ligjor Skocez parashikon përmirësimin e pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortit pasjetues, rritjen e pjesës trashëgimore. Në këtë drejtim janë dhënë sugjerimet e mëposhtme:

- 1) Kur trashëgimlësi nuk ka lënë pasardhës, bashkëshorti pasjetues e trashëgon tërë masën trashëgimore
- 2) Kur trashëgimlënësi ka pasardhës kurse bashkëshorti nuk e ka mbijetuar atëherë pasardhësit e trashëgojnë gjithë masën trashëgimore

---

<sup>218</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.108, 109, 110.

- 3) Kur trashëgimlënësi ka lënë pasardhës dhe bashkëshortin/ten, bashkëshorti pasjetues ka të drejtë në 100 000 funta, kurse nëse masa trashëgimore është më e vogël atëherë bashkëshorti/tja e trashëgon tërë masën trashëgimore. Vlera pasurore mbi 100 000 funta ndahet mes trashëgimtarëve në pjesë të barabarta, një pjesë i takon bashkëshortit kurse pjesa tjetër pasardhësve të trashëgimlënësit.
- 4) Në rastet kur trashëgimlënësin e mbijetojnë të afërmit e tjerë atëherë masa trashëgimore ndahet mes tyre.<sup>219</sup>

Në pasjtim me Ligjin për familje (*The family Law Act*) të vitit 2006 bashkëshortëve jashtëmartesorë heteroseksual apo të gjinisë së njëjtë u njihet e drejta trashëgimore ligjore. Me këtë pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë bazarazohet me pozitën e bashkëshortëve martesorë. Bashkëshorti jashtëmartesorë duhet të vërtetojë se ka qenë në bashkëjetesë me trashëgimlënësin dhe se i plotëson edhe kushtet e tjera të parapara me ligj.

Me bashkëjetesë kuptojmë: 1) dy persona me gjini të kundërt jetojnë në një bashkësi sikur të jenë të martuar dhe 2) dy persona të gjinisë së njëjtë jetojnë në një bashkësi sikur të jenë partnerë civil.<sup>220</sup>

---

<sup>219</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.110-111.

<sup>220</sup> По ату, fq.110.

### 7.2.1.2. Anglia dhe Uelsi

Trashëgimia në Angli është e rregulluar me Ligjin për menaxhimin e pronës të vitit 1925, sipas të cilës kur trashëgimlënësin nuk e kanë mbijetuar pasardhësit e tij a as prindërit atëherë masën trashëgimore e trashëgon bashkëshorti apo partneri civil. Nëse trashëgimlënësin e kanë mbijetuar pasardhësit por jo edhe bashkëshorti atëherë masën trashëgimore e trashëgojnë pasardhësit. E nëse trashëgimlënësin e kanë mbijetuar edhe bashkëshorti/tja dhe pasardhësit atëherë e drejta e pasardhësve shtyhet pasi që përparësi ka bashkëshorti/tja apo partneri civil.

Nga 1 janari i vitit 1996 bashkëshorti/tja apo partneri civil duhet që 28 ditë pas vdekjes ta mbijtojë trashëgimlënësin që të fitoj të drejtën e trashëgimisë. Pasi të pagohen të gjithë borxhet, tatimet e trashëgimlënësit masa pasurore e mbetur ndahet sipas rendit të mëposhtëm:

- 1) Trashëgimia ligjore së bashku me të mirat personale ( me të mira personale në këtë rast kuptojmë mobiljet, enët, automjetet, instrumentet muzikore etj) dhe
- 2) Masa pasurore e mbetur.<sup>221</sup>

-Kur trashëgimlënësin do ta mbijetojë bashkëshorti/tja apo partneri civil, ai/ajo ka të drejtë në shumë fikse të të hollave të njohur si trashëgimi ligjore "*statutory legacy*", vlera e të cilës varët nga ajo se trashëgimlënësin a e ka mbijetuar pasardhësit. Në rastet kur trashëgimlënësin do ta mbijetojnë të afërmit e tjerë, por jo pasardhësit atëherë pjesa që do t'i takojë bashkëshortit pasjetues apo partnerit civil është 200 000 funta. Bashkëshorti pasjetues apo partneri civil do të paraqitet si trashëgimtar i gjithë masës trashëgimore në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës.

Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë as bashkëshortin/ten e as pasardhës atëherë e gjithë vlera e trashëgimisë ligjore hyn në masën pasurore të mbetur.<sup>222</sup>

-Me masën trashëgimore të mbetur nënkuptojmë ajo masë e trashëgimisë e cila mbetet pasi të jetë ndarë trashëgimia ligjore dhe të mirat personale poashtu zë edhe

---

<sup>221</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, q.111-112.

<sup>222</sup> По ату, fq.112.

shtëpinë e përbashkët në të cilën bashkëshorti apo partneri civil ka jetuar deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit.

Ndarje e masës trashëgimore të mbetur varet nga ajo se trashëgimlënësin a e ka mbijetuar bashkëshorti/tja apo pasardhësit dhe të afërmit e tjerë. Nëse trashëgimlënësin e kanë mbijetuar bashkëshorti dhe pasardhësit atëherë një pjesë e trashëgimisë i takon bashkëshortit kurse gjysma e dytë pasardhësve. Pas vdekjes së bashkëshortit pasardhësit e fitojnë të drejtën edhe të pjesës tjetër.<sup>223</sup>

Në të drejtën Angleze bashkëshorti jashtëmartesor nuk ka të drejtën e trashëgimisë, megjithatë ato kanë të drejtë të kërkojnë nga Gjykata që të urdhërohet egzekutimi i trashëgimisë në pajtim me Ligjin për trashëgimi, në mënyrë të njëjtë si në trashëgiminë testamentale.<sup>224</sup>

---

<sup>223</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.112 dhe 113.

<sup>224</sup>По ату, fq.113.

### 7.2.1.3. Irlanda e Veriut

Trashëgimia në irlandën e Veriut është e rregulluar me ligjin për menaxhim me trashëgiminë të vitit 1955. Rregullimi i trashëgimisë në Irlandën e Veriut është shumë i ngjajshëm me jurisdiksonin Anglez, megjithatë, sërish ka disa dallime:

- 1) Kur trashëgimlënësin e kanë mbijetuar fëmijët (apo pasardhësit e tyre më shumë se një), bashkëshorti pasjetues fito 1/3 nga masa trashëgimore e mbetur.
- 2) Kur trashëgimlënësin e ka mbijetuar bashkëshorti apo partneri civil dhe pasardhësit e tyre, atëherë bashkëshorti pasjetues fiton ½ nga masa trashëgimore e mbetur.
- 3) Kur trashëgimlënësin nuk e ka mbijetuar bashkëshorti apo partneri civil e as pasardhësit, prindërit dhe vëllezërit, motrat e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë masën trashëgimore.<sup>225</sup>

Mbretëria e bashkuar njih partneritetet e regjistruara. Pas vitit 2004 (*UK Civil Partnership Act 2004*), partnerët e regjistruar të gjinisë së njëjtë kanë të drejtën e trashëgimisë ashtu si edhe bashkëshorti martesorë.<sup>226</sup>

---

<sup>225</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.114.

<sup>226</sup> [www.succession-europe.eu/hr/united-kingdom/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much\\_](http://www.succession-europe.eu/hr/united-kingdom/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much_) (04.03.2018).

### 7.2.2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

E drejta trashëgimore në Shtet e Bashkuara të Amerikës nuk i nënshtrohet rregullores që është në jurisdiksonin federal, por ajo hyn në sferën e së drejtës private dhe është nën jurisdiksonin e shteteve anëtarë të Federatës.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk egziston vetën një ligj për trashëgimi që do t'i nënshtrohen të gjithë shtet por egzistojnë 50 të drejta të veçanta trashëgimore sa i përket shteteve që e përbëjnë federatën. Si rezultat i kësaj do t'i theksojmë vetëm përpjekjet më kryesore për të drejtën trashëgimore në SHBA.<sup>227</sup>

Një nga përpjekjet më kryesore në të drejtën trashëgimore është ajo për përmirësimin e pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortit. Në vitin 1978 Fondacioni i avokatëve në Amerikë (*American Bar Foundation*) analizuan situatën e ndarjes së pasurisë në rast të vdekjes. Në bazë të studimeve të bëra erdhën në konkludim se bashkëshorti pasjetues duhet të paqitet si trashëgimtar/e e gjithë masës trashëgimore para fëmijëve të trashëgimlënësit pa marrë parasysh a janë fëmijë natyrorë apo të adoptuar. Arsyja që arritën në këtë rezultat është aspekti i shikimit të pozitës së bashkëshortit/tes, si bashkësi ekonomike (*economic partnership*), në të cilën përfitimet dhe humbjet i ndajnë të dy bashkëshortët në bashkësinë e tyre familjare.<sup>228</sup>

Në dekadat e fundit, në të drejtën trashëgimore gjithnjë më i madh është tentimi i shteteve për përforsimin e të drejtave që i takojnë bashkëshortit. Këto synime të shteteve manifestohen nëpërmjet rritjes së pjesës trashëgimore të bashkëshortit pasjetues.

Fillimisht shtete parashikojnë minimum të drejta me vlerë prej 50.000,00 dollar që i takojnë bashkëshortit pasjetues edhe në ato raste kur trashëgimlënësi nuk është në atë situatë për përmbushjen e pjesës plotësuese të bashkëshortit. Tendenca e dytë është se me kalimin e kohës rriten llojet e pronësisë për sende të caktuara të cilët ishin të përfshirë në pjesën e bashkëshortit të tillë si: sigurimi, anuiteti etj.<sup>229</sup>

---

<sup>227</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.114.

<sup>228</sup> По ату, fq.115.

<sup>229</sup> По ату, fq.116.

Përmirësimi i pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortit martesor, në njërin anë me rritjen e pjesës trashëgimore, në anën tjetër solli deri në zvogëlimin e pjesës trashëgimore të fëmijëve. Për shembull në numër më të madh të shteteve parashikojnë që në rastet kur bashkëshorti pasjetues konkuron me fëmijët e përbashkët, atëherë bashkëshorti pasjetues e trashëgon tërë masën trashëgimore.

Në rastet kur bashkëshorti pasjetues konkuron me fëmijët të cilët janë nga një prind tjetër atëherë pjesa e bashkëshortit është një gjysmë plus 100.000 dollarë. Në këtë rast është vendosur kjo zgjidhje sepse mendohet që fëmijët e trashëgimlënësit do të udhëheqin me pasurinë në mënyrë më mirë se sa bashkëshorti.

Janë paraparë raste edhe kur bashkëshorti konkuron me fëmijët e trashëgimlënësit dhe me fëmijët e bashkëshortit pasjetues që nuk rrjedhin nga trashëgimlënësi, në këtë rast e gjithë masa trashëgimore i takon bashkëshortit pasjetues. Tentimet moderne janë të drejtimit që 150 000 dollarët e parë t'i takojnë bashkëshortit pasjetues dhe njëra gjysmë e masës trashëgimore kurse pjesa e mbetur ti takojë fëmijëve.<sup>230</sup>

---

<sup>230</sup> Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011, fq.118.



## 8. Përfundime dhe konkluzione

Martesa është pjesë e jetës, ne si qytetarë jemi subjekt martesorë ose jemi në marrëdhënie familjare, për këtë shkak është e nevojshme të jemi në dijeni me të drejtat që na takojnë ne në këto marrëdhënie.

Çdo njeri është i lirë dhe ka të drejtë t'i kërojë dhe të marrë atë të drejtë që i takon, por, para se gjithash më e rëndësishme është që këto të drejta të jeni mirë të rregulluara dhe të jenë gjithëpërfshirëse.

Tema e këtij punimi përqëndrohet në të drejtat që u takojnë bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë sa i përket aspektit trashëgimorë. Bashkëshortët në rastin e lidhjes së martesës premtojnë se do t'i qëndrojnë besnik njërit tjetrit, do të përkrahin njërin-tjetrin në ditë të mira edhe në ditë të vështira, por në rast të vdekjes vjen instituti i trashëgimisi që bashkëshortëve u njihen disa të drejta dhe detyrime.

Sipas ligjit për trashëgimi bashkëshorti martesor merr pjesë në rendin e parë dhe të dytë të trashëgimisië. Në rendin e parë konkuron bashkë me fëmijët e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre kurse në rendin e dytë me prindërit e trashëgimlënësit. Bashkëshortëve jashtëmartesorë nuk u njihen të drejta trashëgimore, por, vetëm e drejta e mbajtjes dhe e drejta e ushqimit.

Megjithatë, bashkëshortët martesorë jo gjithmonë kanë qenë në situatën siç janë edhe sot. Pozita diskriminuese e gruas ka qenë dominante pothuajse në të gjithë periudhat kohore, në kohërat me të hershme bashkëshortëve martesorë nuk u është njohur e drejta e trashëgimisë, me zhvillimin e shoqërisë erdhi deri në përmirësimin e pozitës së bashkëshortëve. Sot bashkëshorti është pjestar i vërtetë i familjes, madje pjesëtari më i afërt i familjes, pavarësisht mungesës së lidhjes së gjakut. Këto të dhëna sociologjike kanë bërë që të ndryshojë hierarkia e trashëgimtarëve. Qëllimi për këtë të fundit ka qenë që të përmirësojë gjithnjë e më shumë situatën pasurore bashkëshortit pasjetues, duke ruajtur në një lloj mënyre strukturën origjinale të sistemit.

Sot bashkësia martesore formohet në themelin e dashurisë, respektit reciprok dhe të mirëkuptimit, ka ndryshuar koncepti shumëshekullor që martesa lidhej për shkaqe ineresi ose mes shteteve fqinje ose për shkaqe interesi rruajtjen e pasurisë në familje. Lidhja e

marteses në bazë dashurie, pretendimet e mëdha të partnerëve ndaj njërit-tjetrit për një jetë me kualitet më të mirë bëri që të ndyshojë koncepti i martesës. Kështu, martesë nuk ka vetëm funksionin e rriprodhimit, por, edhe funksionin ekonomik, moralit. Vdekja e njërit prej tyre është momenti më i vështirë për partnerin pasjetues pasi që pasojat më të mëdha i ndjen bashkëshorti, pikërisht këtu qëndron edhe përkushtimi i shteteve Evropiane për mbrojtjen e bashkëshortit pasjetues.

Në këtë punim është bërë një analizim i detajuar i pozitës juridik-trashëgimore të bashkëshortëve martesorë ku në ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë vërehen shumë zbrazëtira. Bashkëshortit mund t'i rritet por edhe t'i zvogëlohet pjesa trashëgimore, në rendin e parë dhe në rendin e dytë të trashëgimisë. Në rastet kur vjen deri në zvogëlimin e pjesës trashëgimore të bashkëshortit, ai/ajo gjendet në një pozitë diskriminuese. Do të ishte mirë të bëhej një analizim nga ana e ligjdhënësit për të përmirësuar pozitën bashkëshortit, duke vënë disa dispozita lehtësuese për bashkëshortin pasjetues.

Përveç pozitës së bashkëshortëve martesorë rëndësi të madhe në këtë punim i jepet edhe për pozitën e bashkëshortëve jashtëmartesorë. Kështu në nenin 4 të Ligjit për trashëgimi theksohet se pozita e bashkëshortëve jashtëmartesorë barazohet me pozitën e bashkëshortëve martesorë. Është një rregull që ka shumë zbrazëtira dhe ka nevojë për qartësimin më të përpiktë. Me këtë mund të kuptojmë se nuk është e mjaftueshme vetëm kjo rregull sepse në praktikën e përditshme hasim raste të shumta sipas së cilës nuk mund të mbulohen të gjithë rastet që hasen. Duke nisur nga kjo rregull se pozita e bashkëshortëve jashtëmartesor barazohet me pozitën e bashkëshortëve martesorë, si dhe nga rregulla se personat të cilët jetojnë në bashkësi të vazhdueshme me trashëgimlënësin mund të fitojnë trashëgimi në kushte të caktuara, koncepti i njëjtë duhet të përkrahët për bashkëshortët jashtëmartesorë.

Nga analizat e bëra del se shumica e të rinjve jetojnë në bashkësi jashtëmartesore, në atë bashkësi të cilët i kryejnët të gjithë funksionet familjare dhe kjo është e mjaftueshme si fakt për vërtetimin e bashkësisë së tyre. Mungesa e dispozitave ligjore për rregullimin e bashkëjetesës i detyron të rinjtë (palët) që të lidhin martesë me qëllim që ti fitojnë të drejtat e tyre p.sh. të drejtën e trashëgimisë. Sipas mendimit tim bashkëshortëve jashtëmartesorë duhet tu njihet e drejta e trashëgimisë, në qoftë se nuk egzistojnë pengesa martesore dhe

nën kushte të caktuara si për shembull kohëzgjatje e caktuar (bashkëjetesa të ketë zgjatur së paku 5 vite, në qoftë se në atë bashkësi ka fëmijë atëherë afati duhet të shkurtohet për 3 vite).

Synimi kryesor në lidhje me këtë punim ishte kërkimi shkencor në lidhje me marrëdhëniet e trashëgimisë nëpërmjet krahasimit të këtyre marrëdhënieve me legjislacionet e disa vendeve të ndryshme. Nëpërmjet bërjes së një analize të së drejtës trashëgimore të Republikës së Maqedonisë dhe duke e ballafaquar këtë të drejtë me atë të disa vendeve të marra në analizë, nxirren në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet legjislacioneve të ndryshme, të cilat shërbejnë për harmonizimin dhe përafrimin e praktikave të ndryshme, në një kohë të lëvizjes së lirë të njerëzve, intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike, politike, shoqërore ndërmjet shteteve dhe kapërcimit të barrierave duke shtuar edhe rastet e marrëdhënieve të trashëgimisë dhe pasojat që ato sjellin.

Nga analizimet e bëra mund të konkludojmë se në vendet Evropiane egzistojnë rregulla më të sofistikuara përveq pozitës së bashkëshortëve martesore, në vendet evropiane u njihet trashëgimia edhe partetëve jashtëmartesore jo vetëm të gjinisë së kundër por edhe për partnerë me gjini të njëjtë. Këtu mund të vërmë se në Republika e Maqedonisë duhet të bëhet një angazhim në lidhje me përparimin jo vetëm në aspekt ekonomik të shtetit por edhe në aspekt legjislativ.

Mund të konkludoj se shtetit me organet e veta duhet ti jep një rëndësi edhe më të madhe martesës sepse nga një martesë e shëndetshme, lindin fëmijë të sukseshme dhe me këtë mund të vijë deri në një shoqëri të shëndetshme. Shpresoj se të dhënat në këtë punim do të ndihmojnë jo vetëm për njohjen e të gjithë subjeteve martesore me të drejtat që u takojnë, por edhe për përmirsimin e pozitës juridiko-trashëgimore të bashkëshortëve martesore dhe jashtëmartesore.

## 9. Bibliografija

1. Антиќ Б. Оливер, “Наследно право”, Београд, 2001
2. Apostolova Marsavelska Magdalena, ZAGREBAKI GRADEC POLODAJ, NASLEDNA PRAVA @ENE, zbornik vo cest na Vasilev Haci Mile, “ Sv.Kiril i Metodij” – Praven fakultet “Justinian Prv”, Skopje; 2004
3. Aliu Abdulla, “E drejta civile”, Prishtinë, 2013
4. Aliu Abdulla, Qehaja Rustem, “E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2007
5. Благојевиќ Т. Борислав, Nasledno pravo na SFRJ-sa osvrtom na prava drugih drzava, Zavod za izdavanje udzdenika Socialisticke Republike Srbije, 1969.
6. Благојевиќ Т. Борислав, Антиќ Б. Оливер, “Наследно Право”, Београд, 1991
7. Благојевиќ Т. Борислав, “Наследно право у Југославији”, права република и покрајина, савременена администрација, 1983
8. Charls Gross, The medieval law of intestacy, Harward Law Review, Vol. 18, No.2, 1904.
9. Чавдар Кирил, “Коментар на Законот за наследувањето” Агенција академик, Скопје, 1996
10. Горѓиевиќ Братислав, Сворцан Слободан, “Наследно право”, савремена администрација, Београд, 1992
11. Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Наследно право”, Скопје, 2016
12. Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, “Реформата на наследното право во Република Македонија”, Скопје, 2016
13. Димовска Ана, “Наследно правната положба на брачниот другар во Македонско и компаративно право”, 2011
14. Борислав Т. Благоја, “Правна Енциклопедија”, Београд, 1989
15. Витларов Тодор, Чавдар Кирил, “Збирка на судски одлуки”, Здружение на правници на Република Македонија, Скопје, 2009.
16. Хаџи Василов Вардарски Миле, “Наследно Право”, Скопје, 1983
17. House Hold Faxhall Lin, Gebder and Property in Classical Ahens, The classical Quartery , new series, vol.39, no.1, 1989
18. Podvorica Hamdi, “E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2006.
19. Podvorica Hamdi, “E drejta familjare”, Prishtinë, 2006.

20. Puhan Ivo, "Rimsko Pravo", Naucna Knjiga, Beograd, 1969
21. Трпеновска - Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследното право во Република Македонија", Скопје, 2010
22. Трпеновска-Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Наследувањето во Европа", Скопје, 2011
23. Трпеновска-Спировиќ Љиљана, Мицковиќ Дејан, Ристов Ангел, "Семејно право", Скопје, 2013
24. Трпеновска - Спировиќ Љиљана, "Наследно Право", Штип, 2009
25. Трпеновска - Спировиќ Љиљана, "Аналогија на вонбрачната заедница со брачна заедница", Скопје, 2008
26. Zrinka Erent-Sunko, Obitelj u demokratskoj Ateni-institucija i polis u malom, Zbornik Pravnog Fakultet u Zagrebu, godina 57, broj 3, Zagreb 2007

#### **Akte ligjore,kode**

1. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.80/92.
2. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.83/04.
3. Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.47/96.
4. Ligji për pronësi dhe të drejtar e tjera sendore i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.18/96, 92/08 dhe 139/08.
5. Ligji për notariat të Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.55/07, 86/08 dhe 139/08.
6. Ligji për procedurë jashtkontestimore i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.19/79.
7. Ligji për trashëgimi, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative Jugosllave, nr.35/73
8. Ligji për trashëgimi, Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative Jugosllave, nr.20/1955.
9. Vendimi i Gjykatës Supreme, nr.156/63, 09.01.1964.
10. Vendimi i Gjykatës Supreme, nr.256/58.

11. Kodi civil Gjerman, 01.01.1900.
12. Kodi Civil Austriak, 1811.
13. Kodi civil Francez, 1804.
14. Kodi Civil Zvicëran, 1907.
15. Kodi Civil Italian, 21.04.1942.

### **Literatura e shfrytëzuar nga interneti**

1. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/03/Doktoratura-Laura-Vorpsi-Fakulteti-i-Drejtësisë-Departamenti-i-se-Drejtës-Civile.pdf>
2. <http://alblexus.blogspot.mk/2011/09/bashkeshorti-pasjetues-dhe-trashegimia.html>
3. <https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>
4. <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstënie.aspx?rbtxt=11>
5. <http://mkd-news.com/dete-da-brak-ne-zgolemen-brojot-na-vonbrachni-detsa-vo-makedonija/>
6. <https://kajgana.com/trendot-na-ragjanje-deca-vo-vonbrachna-zaednica-pretstaven-na-mapa>
7. <http://tera.mk/registratsija-na-vonbrachna-zaednitsa-kaj-notar/>
8. [www.succession-europe.eu](http://www.succession-europe.eu)
9. [www.successions-europe.eu/en/italy/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much](http://www.successions-europe.eu/en/italy/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much)
10. [www.succession-europe.eu/hr/united-kingdom/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much](http://www.succession-europe.eu/hr/united-kingdom/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much)
11. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/09/Tema-e-doktoratures-Nertila-Sulce.pdf>
12. [www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/](http://www.successions-europe.eu/en/italz/topics/in-the-absence-of-a-will-who-inherits-and-how-much/)
13. <https://www.slideshare.net/ervinakrasniqi71/e-drejtromake>
14. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Krahina\\_Socialiste\\_Autome\\_e\\_Kosovës](https://sq.wikipedia.org/wiki/Krahina_Socialiste_Autome_e_Kosovës)
15. <http://www.mediaelire.net/lajm/1038/martesa-sipas-drejtës-islame/>
16. <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=128>
17. <http://jusufzimeri.com/e-drejta-e-trashegimise/>